



Organization for Security and  
Co-operation in Europe  
OSCE Mission in Kosovo

## **Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË**

### **Legjislacioni shumëgjuhësh në Kosovë dhe sfidat e tij**

#### **Shkurt 2012**

*Mohim përgjegjësie:*

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

## TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	4
1. HYRJE .....	5
2. LEGJISLACIONI SHUMËGJUHËSH NË KOSOVË: PROJEKTLIGJET .....	7
2.1. Projektligjet në nivel qendror.....	7
2.1.1. Faza ministrore.....	8
2.1.2. Faza ndërministrore .....	9
2.1.3. Faza e Kuvendit të Kosovës.....	12
2.1.4. Faza e Gazetës Zyrtare.....	13
2.1.5. Procesverbalet e Kuvendit – mjet për interpretim të mirëfilltë në rastet e mospërputhjes në mes të versioneve në gjuhë të ndryshme të legjislacionit.....	13
2.1.6. Përkthimi i legjislacionit dytësor .....	14
2.2. Projekt-legjislacioni në nivelin lokal .....	15
2.2.1. Pasqyrë e përgjithshme .....	15
2.2.2. Procesi i hartimit të legjislacionit komunal .....	15
2.3. Rritja e cilësisë së legjislacionit shumë-gjuhësh.....	20
3. LEGJISLACIONI SHUMË-GJUHËSH NË KOSOVË: LEGJISLACIONI NË FUQI ...	22
3.1. Degët ekzekutive dhe ligjvënëse.....	22
3.2. Dega gjyqësore.....	25
4. MEKANIZMAT PËR MBIKËQYRJE DHE AFTËSIM .....	27
4.1. Komisioni i gjuhëve.....	27
4.2. Njësitë për të drejtat e njeriut.....	29
4.3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal .....	29
5. PËRFUNDIM .....	30
6. REKOMANDIMET.....	32

## **FJALOR**

IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MD	Ministria e Drejtësisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në
ZBGZ	Zyra për botimin e Gazetës Zyrtare
ZKK	Zyrat Komunale për Komunitete
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZShNJ	Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike (Zyra e Kryeministrit)

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Zbatimi i plotë i kornizës ligjore që garanton përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare në procesin e hartimit të akteve legjislative në Kosovë është sfidues. Institucionet e Kosovës janë të obliguara të respektojnë përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare në punën e tyre. Megjithatë, përkundër zbatimit të sistemit legjislativ shumëgjuhësh nga organet ligjvënëse, Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) ka vërejtur që përkthimi i projekt-akteve dhe legjislacionit të miratuar mbetet i pakënaqshëm në nivelin qendror si dhe në atë lokal.

Korniza ligjore në këtë kuptim përcakton garancitë shembullore për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore të komuniteteve të ndryshme. Megjithatë duhet përmirësuar zbatimi gjegjës. Dështimi për ta bërë këtë mund të shpie në përjashtimin e tërthortë të komuniteteve joshqiptare nga çështjet publike dhe në shkelje tjera potenciale të drejtave të njeriut. Respektimi i të drejtave gjuhësore jo vetëm që përforcon respektimin e parimeve të barazisë dhe mos-diskriminimit, por edhe përcakton obligimin e institucioneve publike që të krijojnë kushtet e domosdoshme për gëzimin e këtyre të drejtave.

OSBE-ja ka identifikuar një praktikë të shpeshtë të përkthimit të dobët, si dhe mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet versioneve të ndryshme gjuhësore, në nivel qendror e lokal. Dispozitat që rregullojnë përkthimet e projektligjeve nuk janë plotësisht të qarta, derisa vetëdija për rëndësinë e tyre në përfshirje të komuniteteve është e ulët. Praktika e lekturimit sistematik nuk është e vendosur tek institucionet legjislative. Për më tepër, më se e treta e komunave nuk i përkthejnë aktet e tyre legjislative, në drafte apo të miratuara, në gjuhët zyrtare. Praktika e tillë çon në pasiguri ligjore dhe shkel parimin e barazisë para ligjit. Në këtë mënyrë, ajo dobëson besimin publik në institucione dhe sundimin e ligjit në përgjithësi. Si rezultat, mund të minohet respekti dhe besimi në institucione publike dhe sundim të ligjit. Ka hapësirë edhe për përmirësimin e rolit mbikëqyrës të Komisionit të Gjuhëve dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Mekanizmi solid dhe funksional i mbikëqyrjes ka rëndësi thelbësore në sigurimin e përdorimit të barabartë të gjuhëve zyrtare në legjislacion, si dhe cilësinë e domosdoshme të përkthimit.

Kufizimet e përgjithshme buxhetore në sektorin publik, mungesa e kuadrit, mungesa e përkthyesve të kualifikuar si dhe trajnimet e pamjaftueshme, bashkë me vetëdijen e ulët publike për rëndësinë e të drejtave gjuhësore, janë pengesat më madhore për sistemin legjislativ shumëgjuhësh në Kosovë. Kështu, mekanizmat për sigurimin e zbatimit të përputhshmërisë me legjislacionin shumëgjuhësh duhen përforcuar. Në këtë drejtim, ministrinë e nivelit qendror duhet të sigurojnë disponueshmërinë e projekt-legjislacionit në gjitha gjuhët zyrtare gjatë grupeve punuese legjislative. Ministrinë gjithashtu këshillohen të rregullojnë në mënyrë më precize përkthimin e projektligjeve dhe amandamenteve para dorëzimit të legjislacionit në Kuvendin e Kosovës. Në nivel lokal, komunat duhet të sigurojnë që njësia e përkthimit të themelohet në secilën komunë. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mund të marrë parasysh sigurimin e disponueshmërisë së gjitha akteve komunale, në gjitha gjuhët zyrtare të komunës përkatëse, si pjesë formale të rolit të saj mbikëqyrës. Për më tepër, Komisioni i Gjuhëve, Instituti i Kosovës për Administratë Publike, si dhe njësitë e përkthimit në nivel qendror, duhet të pajisen me resurset e duhura financiare për të përmbytur rolin dhe obligimet e tyre në përforcimin e gëzimit të plotë të të drejtave gjuhësore në Kosovë.

## 1. HYRJE

OSBE-ja ka për mandat, ndër të tjera, promovimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit. Në këtë aspekt, ajo ndërmerr veprimtari për të siguruar krijimin e mekanizmave të mirëfilltë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të llogaridhënies publike. Në mënyrë që të parandalojë në fazë të hershme shkeljet potenciale të drejtave të njeriut, OSBE-ja shqyrton, ndër të tjera, projekt-legjislacionin parësor dhe dytësor të përzgjedhur në lidhje me respektimin e standardeve të drejtave të njeriut dhe parimeve të sundimit të ligjit dhe raporton për të metat sistematike.<sup>1</sup>

Legjislacioni është instrumenti kryesor i institucioneve publike për rregullimin e të gjitha sferave të jetës, duke përfshirë edhe sjelljen e individëve. Nëpërmjet tij krijohen të drejtat dhe detyrimet. Prandaj, pritet që legjislacioni të sigurojë një spektër të masave mbrojtëse për të gjithë, duke përfshirë parimin e ligjshmërisë dhe parimin e barazisë para ligjit.<sup>2</sup> Institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për krijimin e kushteve adekuate për të mundësuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të të gjitha komuniteteve. Kjo konsiderohet të jetë parakusht për mbrojtjen e interesave të të gjitha komuniteteve. Gjuha është mjet kryesor në mbrojtjen e këtyre interesave, pasi që mundëson pjesëmarrjen efektive.

Sipas kornizës ligjore, gjuha shqipe dhe ajo serbe janë gjuhë zyrtare në Kosovë.<sup>3</sup> Në disa komuna, gjuhët tjera, si ajo turke dhe boshnjake, gjithashtu gëzojnë statusin e gjuhës zyrtare në komunë.<sup>4</sup> Gjuhët zyrtare kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës dhe të gjithë individët kanë të drejta të barabarta përkitazi me përdorimin e tyre.<sup>5</sup>

Institucionet e Kosovës zbatojnë një sistem të legjislacionit shumëgjuhësh, ku të drejtat e gjera gjuhësore të komuniteteve të ndryshme mbrohen me kornizë legjislative dhe instrumente ndërkombëtare. Kështu gjitha ligjet dhe aktet tjera legjislative duhen hartuar, miratuar dhe shpallur në gjitha gjuhët zyrtare. Korniza ligjore përcakton që legjislacioni bazë duhet të shpallet në pesë gjuhë (shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe angleze).<sup>6</sup> Megjithatë nuk

---

<sup>1</sup> OSBE-ja shqyrton projektligjet dhe legjislacionin tjetër dhe vlerëson pajtueshmërinë e tyre me të drejtat e njeriut dhe standardet e të drejtave të njeriut. Fokusi është në legjislacionin me implikime potenciale për të drejtat e njeriut.

<sup>2</sup> Parimi i ligjshmërisë përcakton që rregullat ligjore duhet të jenë të qasshme, të sakta dhe të parashikueshme (shih paragrafin 49 të Aktgjykimit të GJEDNJ në lëndën *Sunday Times kundër MB*, i datës 26 prill 1979). Është thelbësore që legjislacioni të miratohet dhe të shpallet në një mënyrë të saktë dhe ligjërisht të përcaktuar. Në kontekstin e Kosovës, kjo gjithashtu do të thotë se legjislacioni duhet të jetë në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare. Për më tepër, parimi i barazisë para ligjit njeh se të gjithë trajtohen në mënyrë të barabartë sipas ligjit. Në një sistem të legjislacionit shumëgjuhësh, barazia para ligjit mund të respektohet vetëm nëse ligjet dhe legjislacioni tjetër përputhen plotësisht në versionet e tyre të ndryshme gjuhësore.

<sup>3</sup> Shih nenin 2(1) të Ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, siç është shpallur me Rregulloren 2006/51 të UNMIK-ut, i datës 20 tetor 2006. Po ashtu, shih nenin 5 (1) të Kushtetutës.

<sup>4</sup> Neni 2(3) i Ligjit për përdorimin e gjuhëve përcakton që “në komunat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e të cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën së paku 5 përqind të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do ta ketë statusin e gjuhës zyrtare në atë komunë dhe do përdoret barabartë me gjuhët zyrtare. Pavarësisht kësaj që u tha më lartë, në mënyrë të veçantë, në komunën e Prizrenit gjuha Turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare. Rrjedhimisht, gjuha turke gëzon statusin e gjuhës zyrtare në komunën e Prizrenit dhe atë të Mamuša/Mamushës/Mamuša, ndërsa gjuha boshnjake gëzon këtë status në komunat: Prizren, Dragash/Dragaš, Pejë/Peć dhe Istog/Istok.

<sup>5</sup> Shih nenin 2(2) dhe 2(3) të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

<sup>6</sup> Shih nenin 5(4) të Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe nenin 5 të Ligjit nr. 03/L-190 për gazetën zyrtare, 4 gusht 2010.

ekzistojnë dispozita të ngjashme në lidhje me shpalljen e legjislacionit dytësor në këto gjuhë.<sup>7</sup> Dokumentet zyrtare zakonisht shpallen në gjuhët zyrtare, d.m.th. në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Por Ligji për përdorimin e gjuhëve përcakton që institucionet e Kosovës do të përdorin gjuhën angleze në punën e tyre, kontaktet dhe dokumentet zyrtare gjatë mandatit të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).<sup>8</sup> Prandaj legjislacioni dytësor përgjithësisht përkthehet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Në bazë të statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare, korniza ligjore përcakton që gjitha versionet e legjislacionit në gjuhët zyrtare janë njëjtë autentike. Sipas kësaj, përputhja e plotë mes versioneve të ndryshme, por edhe cilësia e kënaqshme e secilit version, janë çështje thelbësore.

Në dritën e asaj çfarë u tha më lart, ky raport vlerëson statusin aktual të sistemit të legjislacionit shumëgjuhësh në Kosovë dhe nënvizon sfidat dhe të metat e tij. Për këtë qëllim, ai analizon shkallën e respektimit të përdorimit të barabartë të gjuhëve zyrtare në Kosovë brenda kornizës ligjore të Kosovës. Raporti është kryesisht për aktorët e përfshirë në hartimin e legjislacionit shumëgjuhësh në nivelin qendror dhe lokal. Ai ka për qëllim që të nënvizojë rëndësinë jetike që i atribuohet arritjes së një cilësie më të lartë për të gjitha versionet gjuhësore të projektligjeve dhe legjislacionit të miratuar. Pa marrë parasysh rëndësinë e pranuar me ligj të gjuhës angleze në procesin legjislativ, fokusi i këtij raport është në gjuhët zyrtare.

Raporti përbëhet nga gjashtë pjesë. Pas një hyrjeje të shkurtër në pjesën I, pjesa II paraqet një pasqyrë të hartimit të legjislacionit shumëgjuhësh në nivelin qendror dhe lokal. Së pari, shqyrtohet thellësisht procesi i hartimit të legjislacionit në nivelin qendror që nga faza fillestare te ministria sponsorizuese deri tek shpallja e tij në Gazetën Zyrtare, duke theksuar kështu praktikën e përkthimit dhe të metat. Së dyti, paraqitet praktika dhe përvoja e hisedarëve gjegjës në nivelin lokal. Pjesa III përqendrohet në legjislacionin shumëgjuhësh dhe aty vlerësohet ndikimi praktik i gabimeve gjuhësore me paraqitjen e disa shembujve konkretë. Pjesa IV nënvizon rolin e mekanizmave mbikëqyrës dhe trajnues në Kosovë me qëllim të monitorimit dhe sigurimit të disponueshmërisë së legjislacionit në gjuhët zyrtare. Përfundimisht, raporti përfundon me një konstatim në pjesën V dhe me disa rekomandime në pjesën VI.

Sa i përket aspektit metodologjik, si një vlerësim afatgjatë, raporti është bazuar në tre burime kryesore: (a) veprimtarinë e shqyrtimit afatgjatë dhe analizën e legjislacionit nga OSBE-ja deri në gusht të vitit 2011; (b) intervistat e strukturuar të zhvilluara nga OSBE-ja me zyrtarët gjegjës në nivel qendror e të cilët janë të përfshirë në hartimin e ligjeve dhe zbatimin e tyre në planin afatgjatë. Zyrtarët e tjerë të cilët u intervistuan ishin zyrtarët ligjorë komunalë, përkthyesit komunalë, përfaqësuesit e komuniteteve dhe zyrtarët të cilët punojnë në drejtoritë administrative komunale. Intervistat u zhvilluan nga ekipet fushore të OSBE-së në 33 komuna që zbatojnë sistemin juridik të Kosovës, në qershor dhe korrik të vitit 2010; dhe (c) të dhënat e mbledhura vazhdimisht nga OSBE-ja në komunat e Kosovës, nëpërmes konsultimeve me zyrtarët lokalë të cilët marrin pjesë në procesin legjislativ në nivel lokal.

<sup>7</sup> Sipas pikës 2.8, paragrafi 2 i nenit 4 të Ligjit nr. 03/L-190 për Gazetën Zyrtare, legjislacioni dytësor shpallet në faqen e Gazetës Zyrtare vetëm me kërkesë të Kryeministrit.

<sup>8</sup> Shih nenin 34 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

## 2. LEGJISLACIONI SHUMËGJUHËSH NË KOSOVË: PROJEKTLIGJET

### 2.1. Projektligjet në nivel qendror

Kjo pjesë paraqet një pasqyrë e hartimit të legjislacionit shumëgjuhësh në nivelin qendror. Këtu procesi shqyrtohet hollësisht që nga faza e tij fillestare në ministrinë sponsoruese, përgjatë fazës ndërmministrore dhe asaj në Kuvendin e Kosovës, e deri te shpallja në Gazetën Zyrtare. Vlerësimi i paraqitur në këtë pjesë buron nga intervistat e strukturuar me zyrtarët gjegjës në ministrinë e përzgjedhura, Zyrën e Kryeministrit (ZKM), Kuvendin e Kosovës dhe Zyrën për botimin e Gazetës Zyrtare (ZBGZ).<sup>9</sup>

Në praktikë, përkthimi kryhet nga shërbyesit civil apo përkthyesit e kontraktuar. Zgjedhja e praktikave të përkthimit është në liri të veprimit të ministrisë sponsoruese për shkak se nuk ekziston ndonjë akt ligjor që rregullon çështjen nëse përkthimi duhet të kryhet nga brenda ose jo.<sup>10</sup> Procedurat e brendshme të prokurimit zbatohen në rastet kur përkthimi i kontraktohet një përkthyesi të kontraktuar. Në shumicën e rasteve, zyrtarët e intervistuar janë shprehur të kënaqur me përkthimin e siguruar nga përkthyesit e kontraktuar.<sup>11</sup> Megjithatë, janë raportuar shembuj kur përkthyesit e kontraktuar kanë siguruar përkthim të dobët të projektligjeve.<sup>12</sup> Si pasojë, projektligjet në gjuhën e përkthyer zakonisht përmbajnë përdorim të pasaktë të terminologjisë ligjore dhe gabime tjera të përkthimit.

Kapacitetet e punësimit të personelit të njësive të përkthimit në ministri dallojnë shumë, duke filluar me nga një deri në pesë përkthyes për ministri.<sup>13</sup> Megjithatë, punësimi në numër të ulët i personelit duket se është një problem i zakonshëm dhe është e vështirë që të punësohen kandidatë të kualifikuar për shkak të kufizimeve buxhetore në sektorin publik.<sup>14</sup> Si pasojë, personat që mbajnë pozitën e përkthyesit në ministri shpesh nuk kanë kualifikimet e duhura dhe përvojën profesionale. Sipas zyrtarëve të intervistuar, trajnimet profesionale për ndërtim të kapaciteteve në bashkërendim me faktorët stimules, si rritja e pagës, mund të adresojnë këto probleme në mënyrë të suksesshme.

---

<sup>9</sup> Janë intervistuar përfaqësuesit e zyrave ligjore në këto institucione: ZKM (zyrtari ligjor) më 24 qershor 2010; Ministrinë e Drejtësisë (MD) (zyrtari ligjor) më 16 qershor 2010; Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) (Drejtori i departamentit ligjor) më 22 qershor 2010; Ministrinë e Administratës Publike (MAP) (zyrtari ligjor dhe koordinatori i njësive për të drejtat e njeriut) më 30 qershor 2010; Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) (zyrtari ligjor) më 30 qershor 2010; Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK) (zyrtari ligjor dhe përfaqësuesi i njësive për të drejtat e njeriut) më 15 qershor 2010; Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) (Drejtori i zyrës ligjore) më 29 qershor 2010; si dhe në Kuvendin e Kosovës (Drejtori i zyrës ligjore) më 6 korrik 2010.

<sup>10</sup> Për shembull, MD përdor kapacitetet e brendshme të përkthimit kurse MPB-ja kryesisht i drejtohet përkthyesve të jashtëm të kontraktuar.

<sup>11</sup> Shumë prej personave të intervistuar ndajnë pikëpamjen që shërbimet e përkthimit të siguruara përkthyesit e kontraktuar janë të cilësisë më të lartë sesa ato të ofruara nga njësitë e brendshme të përkthimit.

<sup>12</sup> Kjo është vërejtur në MD dhe MAP.

<sup>13</sup> Raportuar nga Komisioni i Gjuhëve duke u bazuar në një raport të hartuar nga ish njësia monitoruese për përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet qendrore të Kosovës, prill-dhjetor 2009. Gjithashtu, partnerët e intervistuar kanë konfirmuar dallimet e mëdha në punësimin e personelit në njësitë e përkthimit në ministrinë e Kosovës edhe për shkak të praktikave të ndryshme të kontraktimit të jashtëm.

<sup>14</sup> Siç raportohet, kandidatët e kualifikuar shpesh herë gjejnë vende pune me pagë më të mirë në Kosovë edhe me bashkësinë ndërkombëtare.

### 2.1.1. Faza ministore

Rregullorja e punës e Qeverisë është instrumenti themelor ligjor që rregullon procesin e hartimit të legjislacionit në nivel qendror.<sup>15</sup> Ajo përkufizon fazat e veçanta të hartimit të legjislacionit në nivelet ministore dhe ndërministrare, rolin e aktorëve të ndryshëm të përfshirë dhe kushtet e posaçme të hartimit.

Projekti i parë i një akti ligjor hartohet nga zyra ligjore e ministrisë gjegjëse, në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse të fushës së caktuar. Më pas, sekretari i përhershëm i ministrisë merr vendim për themelimin e një grupi punues ministror<sup>16</sup> për shqyrtimin e projektligjit. Ky grup punues ministror përbëhet nga anëtarët e drejtorive të ndryshme të ministrisë gjegjëse, duke përfshirë edhe një përfaqësues nga zyra ligjore, i cili bashkërendon punën e grupit punues.<sup>17</sup> Gjithashtu, njësia për të drejtat e njeriut e ministrisë gjegjëse duhet ftuar për të marrë pjesë në procesin e hartimit.<sup>18</sup> Përveç këtyre, ministria duhet të zhvillojë konsultime me publikun.<sup>19</sup>

Rregullorja e Punës e Qeverisë përcakton që një projektligj duhet të jetë plotësisht i hartuar dhe i vënë në dispozicion në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe para se të dorëzohet në qeveri, në ndonjë ministri apo agjenci të qeverisë, ose te ndonjë grup punues i të lartpërmendurve.<sup>20</sup> Për më tepër, të gjitha institucionet e Kosovës kanë për obligim që të mbajnë dhe që të nxjerrin të gjitha dokumentet zyrtare në të dyja gjuhët zyrtare.<sup>21</sup> Kjo përfshin edhe projektligjet. Megjithatë, mungon një dispozitë e veçantë për përkthim gjatë punës së grupeve punuese për hartimin e projektligjeve.<sup>22</sup>

Gjatë punës së tyre, institucionet e Kosovës kanë për obligim që të respektojnë përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare. Kjo vlen edhe për procesin e hartimit të legjislacionit që nga faza e tij fillestare. Praktika e përgjithshme e punës vetëm në njërin prej gjuhëve zyrtare është shkelje të kornizës ligjore dhe minon statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare. Për më tepër, kjo i kontribuon përjashtimit të tërthortë të pjesëtarëve të komuniteteve joshqiptare që në fazën fillestare të procesit të hartimit.

---

<sup>15</sup> Shih nenin 1 të Rregullores së Qeverisë nr. 1/2007 për rregulloren e punës, 24 janar 2007; më 7 shtator 2001, Qeveria nxori Rregulloren e re nr. 09/2011 për Rregulloren e Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës; sipas një përfaqësuesi të ZShNJ, dispozitat gjegjëse për procesin e hartimit të legjislacionit do të zbatohen nga institucionet e Kosovës vetëm pas miratimit të strategjisë legjislative të Kosovës për vitin 2012.

<sup>16</sup> Vendimi i sekretarit të përhershëm gjithashtu përfshin përbërjen e grupit punues.

<sup>17</sup> Shih nenin 26(1) dhe pjesën tjetër të rregullores së punës të Qeverisë.

<sup>18</sup> Shih nenin 10(5) të Udhëzimit administrativ nr. 2007/4 për njësitë e të drejtave të njeriut në kuadër të Qeverisë së Kosovës.

<sup>19</sup> Shih nenin 27(1) të rregullores së punës të Qeverisë; megjithatë kjo dispozitë nuk sqaron se kur dhe në çfarë mënyre duhet të zhvillohen konsultimet me publikun.

<sup>20</sup> Shih nenin 36(1) të rregullores së punës të Qeverisë. Përveç kësaj, neni 27 i rregullores së punës të Qeverisë përcakton që zyra ligjore është përgjegjëse për procedurat e hartimit të draftit të parë në pajtim me parimet e hartimit të Rregullores së Punës së Qeverisë.

<sup>21</sup> Shih nenin 4(5) të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

<sup>22</sup> Neni 2(b) i Ligjit nr. 2003/12 për qasjen në dokumentet zyrtare, siç është shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/32, i datës 6 nëntor 2003, përmban një përkufizim të gjerë të një “dokumenti” që është çdo përmbajtje pavarësisht nga forma e saj (e shkruar në letër, elektronike apo vizuale) për politikën, veprimtarinë dhe vendimet e institucioneve. Neni 3(3.3) i të njëjtit ligj përfshin të gjitha dokumentet që mbahen, hartohen apo pranohen nga një institucion dhe që janë në pronësi të tij brenda fushëveprimit të ligjit. Dispozita të ngjashme përfshirëse përdoren në Ligjin nr. 03/L-215 për qasjen në dokumentet publike që ka hyrë në fuqi më 25 nëntor 2010.



## *Praktika e përkthimit*

Të gjithë aktorët e intervistuar njëzëri iu kanë referuar rregullores së punës të qeverisë si bazë të tyre ligjore dhe si udhëzuesin kryesor gjatë hartimit të legjislacionit. Megjithatë, gjatë zhvillimit të intervistave është zbuluar që Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) ishte e vetmja ministri që përmbushte detyrimet e veta gjatë fazës së hartimit të legjislacionit, duke zbatuar një praktikë të hartimit të njëkohshëm në të dyja gjuhët zyrtare. Domethënë, projektligjet thuheshin të ishin ofruar dhe përpunuar në gjuhën shqipe dhe atë serbe që nga fillimi i procesit të hartimit ligjor, si dhe që përkthyesi ishte i pranishëm në të gjitha seancat e grupit punues. Prandaj, sipas MKK-së, të gjitha ndryshimet bëhen njëkohësisht në të dyja gjuhët zyrtare.<sup>23</sup> Rëndësia e këtij procesi në arritjen e përputhshmërisë me kornizën ligjore qëndron në mundësinë e të siguruarit të statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare si dhe përbën një bazë të qëndrueshme për pjesëmarrje efektive të gjitha komuniteteve në procesin e hartimit që në fazën e tij fillestare.

Në ministritë e tjera, drafti i parë i një teksti ligjor zakonisht hartohet dhe shqyrtohet nga grupi punues ministror vetëm në gjuhën shqipe.<sup>24</sup> Përkthimi në gjuhën serbe dhe atë angleze bëhet vetëm pasi që të jetë finalizuar projektligji fillestar. Disa persona të intervistuar kanë deklaruar që përkthimi në gjuhën angleze ose serbe sigurohet aty për aty, pra vetëm sipas kërkesës së pjesëmarrësve të grupit punues.<sup>25</sup> Megjithatë, në shumicën e rasteve, e tërë faza fillestare e procesit të hartimit të legjislacionit kryhet vetëm në gjuhën shqipe.

Sipas personave të intervistuar, mungesa e përkthimit gjatë fazave të ndryshme të procesit të hartimit buron nga mungesa e burimeve të kualifikuara njerëzore dhe financiare. Përveç kësaj, ngarkesa e punës legjislative e disa ministrive, si e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) apo e Ministrisë së Drejtësisë, është krahasueshëm më e madhe se e disa të tjerave, si ajo e MKK-së. Gjithashtu, grupet punuese shpesh përbëhen vetëm nga pjesëtarët që i përkasin komunitetit shqiptar të Kosovës dhe pjesëmarrësit nga komunitetet e tjera të cilat flasin gjuhën shqipe. Siç pohohet, kjo i kontribuon më tej ngurrimit për të përkthyer ndryshimet gjatë punës së grupit punues ministror. Në përgjithësi, aktorët gjegjëse duket se konsiderojnë që nuk është e nevojshme apo e arsyeshme që projektligjet të përkthehen në fazën fillestare.

### **2.1.2. Faza ndërministrore**

Pasi që të përfundohet projekti i aktit ligjor nga ministria gjegjëse, ai i dorëzohet Zyrës për Shërbimet e Ndihmës Juridike (ZShNJ), në kuadër të ZKM-së, për një shqyrtim fillestar para themelimit të grupit punues ndërministror.<sup>26</sup> Disponueshmëria e projektligjit në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze është një prej parakushteve themelore për vlerësim pozitiv nga ana e ZShNJ<sup>27</sup>, si dhe për rekomandimin e saj sekretarit të përhershëm të ZKM-së për themelimin e grupit punues ndërministror. Ky grup punues zakonisht përbëhet nga përfaqësuesit e ZShNJ, ministritë e ndryshme, zyrtarët nga institucionet e tjera të Kosovës dhe nga bashkësia

<sup>23</sup> Megjithatë, OSBE-ja ka pranuar raporte që një praktikë e tillë nuk është zbatuar plotësisht nga MKK-ja në takimet e grupit punues për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim.

<sup>24</sup> Kjo është vërejtur në MD, MPB, MAP, MPMS, MAPL si dhe në ZKM.

<sup>25</sup> Kjo është vërejtur në MPMS, MAP dhe MPB, si dhe në ZKM.

<sup>26</sup> Shih nenin 29(3) të rregullores së punës të Qeverisë; grupi punues ndërministror gjithashtu njihet si “Grupi Punues Qeveritar”.

<sup>27</sup> Shih nenet 28, 31, 32 dhe 36 të rregullores së punës të Qeverisë.

ndërkombëtare.<sup>28</sup> Për më tepër, në këtë fazë përfaqësuesit e shoqërisë civile zakonisht ftohen për të marrë pjesë në procesin e hartimit legjislativ.<sup>29</sup> Grupi punues ndërministror është zakonisht më i madh dhe më i gjerë në përbërjen e tij sesa grupi punues ministror. Prandaj përkthimi i rregullt i ndryshimeve dhe i versioneve të projektligjeve është edhe më i rëndësishëm gjatë kësaj faze, duke qenë se nxit pjesëmarrjen e drejtpërdrejt të komuniteteve joshqiptare në procesin publik të vendimmarrjes.

Pasi që projektligji të jetë finalizuar në grupin punues ndërministror, ai i kthehet ZShNJ për shqyrtim përfundimtar. Pastaj, pasi që ZShNJ të shqyrtojë historikun procedural dhe pasi që t'i bëjë plotësimet dhe ndryshimet në pajtim me nenin 36 të rregullores së punës, atëherë qeveria, e kryesuar nga Kryeministri, vendos nëse projektligji duhet t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës.<sup>30</sup> Duhet theksuar që në shtator të 2011-ës, Qeveria ka miratuar një Rregullore të re të Punës, e cila përcakton konsultimin paraprak të organit hartues me institucionet gjegjëse, duke përfshirë edhe Këshillin Konsultativ për Komunitete,<sup>31</sup> para dorëzimit të aktit ligjor për trajtim nga Qeveria.

### *Praktika e përkthimit*

Ngjashëm me procesin në nivelin ministror, ndryshimet e projektligjit gjatë punës së grupit punues ndërministror zakonisht shënohen vetëm në versionin e gjuhës shqipe. Përkthimi i ndryshimeve në gjuhën angleze dhe atë serbe bëhet vetëm kur projektligji është i gatshëm për dorëzim te ZKM; përkthimi gojor gjatë mbledhjeve të grupit punues zakonisht nuk sigurohet fare. Në të vërtetë, OSBE-ja ka gjetur se shumë persona të intervistuar duket se besojnë gabimisht që ata përmbushin obligimin ligjor duke përkthyer tekstin e projektligjit në gjuhët e ndryshme vetëm pasi që grupi punues të ketë finalizuar draftin.<sup>32</sup>

Megjithatë, përkthimi verbal gjatë secilës mbledhje të grupit punues është çelës për lehtësimin e përfshirjes efektive të pjesëtarëve të komuniteteve joshqiptare. Veçanërisht në lidhje me grupet punuese që punojnë për disa javë rresht, versionet e përditësuara të projektligjeve duhet të përkthehen rregullisht në mënyrë që pjesëmarrësit e grupit punues të njoftohen për përparimin e arritur në hartim dhe për të shqyrtuar nëse ndryshimet, për të cilat është arritur pajtim, janë pasqyruar në versionet gjegjëse të projektligjit.

Një problem shtesë është se cilësia e përkthimit është shpesh e dobët, pra edhe kur përkthimi i ndryshimeve sigurohet gjatë procesit të grupit punues ndër-ministror. Përkthyesit priren që

<sup>28</sup> Shih nenet 32 dhe 89 të rregullores së punës të Qeverisë. Përveç ministrive të cilat marrin pjesë në grupin punues për shkak të interesave të posaçme dhe/apo ekspertizës në lidhje me projektligjin, Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe MD duhet që gjithmonë të jenë të përfaqësuara në grupin punues ndër-ministror dhe të paraqesin vlerësimet e tyre përkatëse për projektligjin. Gjithashtu, Ministria e Integritimit Evropian (ish Agjencia për Integrim Evropian – shih Vendimin e Qeverisë nr. 2/118, i datës 2 prill 2010) duhet të marr pjesë dhe të paraqet vlerësimin e saj në lidhje me pajtueshmërinë e projektligjit me të drejtën e BE-së.

<sup>29</sup> Rregullorja e punës e Qeverisë nuk rregullon në hollësi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile. Megjithatë, neni 26 kufizon në shtatë numrin e pjesëmarrësve në grupin punues ministror; prandaj, si alternativë, përfaqësuesit e shoqërisë civile ftohen që të marrin pjesë në punën e grupit punues ndërministror që ka 10, ose 15 pjesëmarrës në rastet të veçanta (neni 32(2) i rregullores së punës të Qeverisë).

<sup>30</sup> Shih nenet 32, 33 dhe 35(3) të rregullores së punës të Qeverisë.

<sup>31</sup> Shih nenin 7, paragrafi 110 të Rregullores së re të Punës nr. 09/2011 të Qeverisë së Kosovës, 7 shtator 2011. Procesi i ri i konsultimit paraprak është në pajtim me mandatin e Këshillit Konsultativ për Komunitete, për t'i dhënë komuniteteve mundësinë e komentimit, në faza të hershme, ndaj iniciativave ligjore apo të politikave të përgatitura nga Qeveria, ashtu siç është parashikuar me nenin 60, paragrafi 3(2) të Kushtetutës.

<sup>32</sup> Kjo është vërejtur në MD, MPB, MAP, MPMS si dhe në ZKM.

të përkthejnë fjalët apo shprehjet pa marrë parasysh kontekstin e gjerë ligjor të dispozitës gjegjëse. Kjo ka rezultuar me përkthim të pasaktë ose edhe të gabuar që mund t'ia ndërrojë domethënien një neni të caktuar.<sup>33</sup>

Në shembujt në vijim paraqitet përkthimi i pasaktë ose me gabime që OSBE-ja i ka hasur gjatë veprimtarisë së shqyrtimit ligjor.

### *Shembujt*

#### *Neni 3, projektligji kundër terrorizmit<sup>34</sup>*

Versioni në gjuhën shqipe<sup>35</sup> i kësaj dispozite përcakton një përkufizim të një vepre penale ndërsa versionin në gjuhën serbe e cilëson po të njëjtin akt si një kundërvajtje. Ky gabim përsërit në tërë tekstin.

Cilësimi i një vepre si vepër penale ose kundërvajtje rezulton me pasoja ligjore të ndryshme me mundësi të ndikimit në të drejtat dhe liritë themelore të individit të përfshirë. Derisa ky raport ishte në përgatitje e sipër, ministria përkatëse i dorëzoi ZSHNJ-së versionin më të ri të *Ligjit kundër terrorizmit*, mirëpo gabimi prapë nuk ishte korigjuar.

#### *Neni 19 (1)(1.4), projektligji për Avokatin e Popullit<sup>36</sup>*

Në versionin në gjuhën shqipe dispozita thotë: “mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme nuk janë shterur”<sup>37</sup>; ndërsa në versionin në gjuhën serbe është shkruar “mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme janë shterur”<sup>38</sup>.

Përkthimi i dobët i kësaj dispozite, që rezulton me një mospërputhje midis dy versioneve në gjuhët zyrtare, shkakton huti lidhur me disponueshmërinë e mjetit juridik. Me gjithë përpjekjet e OSBE-së, kjo pasaktësi nuk u korigjuar.<sup>39</sup> Fatkeqësisht, ky gabim ilustron moskushtimin e vëmendjes në hollësitë dhe përbën pengesë për përpjekjet për të përmirësuar procesin e hartimit të legjislacionit shumëgjuhësh në Kosovë.

#### *Neni 17 (5), projektligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore<sup>40</sup>*

Në versionin në gjuhën shqipe dispozita thotë “bartja e të drejtës pronësore”<sup>41</sup>, ndërsa në versionin në gjuhën serbe është shkruar “pranon bartjen e të drejtës banesore”<sup>42</sup>.

<sup>33</sup> Kjo është vërejtur në MPMS.

<sup>34</sup> Ky projektligj ishte pjesë e strategjisë legjislative për vitin 2010, miratuar me Vendimin nr. 02/101, i datës 30 dhjetor 2009, dhe është hartuar dhe sponsorizuar nga ZKM-ja.

<sup>35</sup> Ju lutemi vëreni: përkthimi në gjuhën angleze në shembujt e paraqitur, për të theksuar dallimet, buron nga përkthimi që OSBE-ja ia ka bërë neneve në versionet gjegjëse me qëllim të krahasimit të versioneve në gjuhën shqipe dhe atë serbe të ligjeve dhe projektligjeve në këtë raport.

<sup>36</sup> Projektligji ka qenë pjesë e Strategjisë Legjislative 2010, të miratuar me vendimin e Qeverisë nr. 02/101 të datës 30 dhjetor 2009, dhe bartëse e procesit të hartimit të tij ishte MD. Projektligji u miratua në 27 gusht 2010 si Ligji nr. 03/L – 195 për Avokatin e Popullit; Neni 19(1)(1.4) u bë neni 20(1)(1.4).

<sup>37</sup> Theksi i shtuar.

<sup>38</sup> Theksi i shtuar.

<sup>39</sup> Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit ka hyrë në më 7 shtator 2010.

<sup>40</sup> Ky projektligj ka qenë pjesë e Strategjisë Legjislative 2010 të miratuar me vendimin e Qeverisë nr. 02/101 të datës 30 dhjetor 2009. Bartëse e procesit të hartimit të këtij projektligji ishte Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor.

<sup>41</sup> Theksi i shtuar.

<sup>42</sup> Theksi i shtuar; gabimi në përkthim nuk ishte korigjuar para se projektligji t'i dorëzohej Kuvendit të Kosovës në 2010; gabimi u përmirësua vetëm pasi që Kuvendi i ktheu projektligjin Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe kjo e fundit e dorëzoi sërish projektligjin në gusht 2011.

E drejta pronësore dhe e drejta banesore janë dy lloje të ndryshme të të drejtave pasurore që ngërthejnë në vetvete të drejta dhe detyrime të ndryshme. Gabimi i mësipërm në përkthim nuk u korrigjua para se projektligji t'i dorëzohej Kuvendit të Kosovës. Derisa ky raport ishte në hartim e sipër, Kuvendi ia ktheu projektligjin Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe kjo e fundit ishte në proces të rishikimit të projektligjit.

Shembujt e sipërpërmendur gjithashtu ilustrojnë nevojën për krijimin e një mekanizmi të lektorimit, i cili do të shtjellohet më në hollësi në Nën-pjesën C të këtij Kapitulli.

### 2.1.3. Faza e Kuvendit të Kosovës

Rregullorja e punës e Kuvendit të Kosovës është instrumenti kryesor me të cilin rregullohet organizimi dhe funksionimi i Kuvendit të Kosovës dhe i organeve të tij.<sup>43</sup> Duke i respektuar të njëjtat parime që janë të përcaktuara në Rregulloren e punës së Qeverisë dhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve, ky instrument përcakton që çdo projektligj që i dorëzohet për shqyrtim Kuvendit të Kosovës të përkthehet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.<sup>44</sup>

Divizioni për Standardizim dhe Harmonizim Ligjor, Këshillim Juridik, Kërkim dhe Bibliotekë<sup>45</sup> i Kuvendit të Kosovës është përgjegjës për rishikimin e projektligjeve pas dorëzimit të tyre në Kuvend nga ZKM-ja. Ndonëse kjo zakonisht nënkupton kontrollimin e disa aspekteve zyrtare të caktuara (p.sh. struktura e bazës ligjore ose përputhshmëria me legjislacionin e BE-së), kohë pas kohe divizioni identifikon edhe gabimet gjuhësore ose dallimet midis versioneve në gjuhë të ndryshme të të njëjtit projektligj. Prandaj raporti preliminar mbi projektligjet, të cilin divizioni ua dorëzon komisioneve të Kuvendit të Kosovës para leximit të dytë, zakonisht përmban rekomandime për përmirësimin e gabimeve gjuhësore.<sup>46</sup> Ndërsa, lektorimin sistematik të ligjit për gabime gjuhësore dhe harmonizimin e versioneve të tij në të tre gjuhët divizioni e fillon vetëm pas miratimit të tij.<sup>47</sup>

#### *Praktika e përkthimit*

Përkthimin simultan nga gjuha shqipe në atë serbe, turke e angleze, dhe anasjelltas, gjatë seancave plenare të Kuvendit të Kosovës (leximi i parë dhe i dytë) e siguron njësia e

<sup>43</sup> Shih nenin 1 e Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës, të datës 29 prill 2010.

<sup>44</sup> Shih nenin 54(2) e Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës.

<sup>45</sup> Shih Rregulloren për organizimin e brendshëm të Kuvendit të Kosovës – Shtojca 1 për përshkrimin e detyrave të zyrtarëve të administratës së Kuvendit, e nxjerrë nga Kryesia e Kuvendit më 12 tetor 2010; Departamenti për Çështje Ligjore dhe Procedurale përbëhet nga Divizioni për Standardizim dhe Harmonizim Ligjor, Këshillim Juridik, Kërkim dhe Bibliotekë, Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale dhe Divizioni për Mbështetje Komisioneve Parlamentare.

<sup>46</sup> Shih nenin 69 të rregullores së punës së Kuvendit ku është paraqitur lista e komisioneve të përhershme dhe funksionale të Kuvendit. Këto komisione janë të angazhuara në shqyrtimin e projektligjeve.

<sup>47</sup> Kjo informatë kryesisht bazohet në intervistën me përfaqësuesit e Departamentit për Çështje Ligjore dhe Procedurale, të mbajtur më 6 korrik 2010. Drejtori i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Procedurale ka deklaruar që projektligjet që i dorëzohen Kuvendit të Kosovës shumë shpesh përmbajnë gabime gjuhësore. Në të shumtën e rasteve, këto gabime gjuhësore nuk ndikojnë në aspektin përmbajtësor të projektligjit, meqë zakonisht fjala është për gabime gramatikore, gabime sintaksore dhe gabime daktilografie të parëndësishme. Mirëpo, ka gabime gjuhësore të cilat çojnë peshë e që e shtyjnë Departamentin për Standardizim dhe Harmonizim Ligjor, Këshillim Juridik, Kërkim dhe Bibliotekë t'u dedikojë më shumë kohë korrigjimeve gjuhësore se sa analizimit të aspekteve juridike të projektligjeve.

përkthimit.<sup>48</sup> Përkthimi simultan nga gjuha shqipe në atë serbe dhe anasjelltas, dhe, me kërkesë të ndonjë anëtari të komisionit, nga gjuha shqipe në gjuhën turke dhe anasjelltas gjithmonë sigurohet edhe për takimet e komisioneve parlamentare. Mirëpo, gjatë takimeve të komisioneve nuk bëhet shqyrtimi i tërësishëm i projektligjeve për nga aspekti gjuhësor dhe as përkthimi me shkrim i ndryshimeve dhe i plotësimeve. Pasi që komisionet të kenë vendosur lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e caktuara, ato menjëherë përfshihen në versionet në gjuhën shqipe dhe serbe të projektligjit dhe, nëse është e nevojshme, në të gjitha gjuhët tjera. Pasi që komisionet përfundojnë punën e tyre, Divizioni për Standardizim dhe Harmonizim Ligjor, Këshillim Juridik, Kërkim dhe Bibliotekë bën përkthimin e projektligjit në gjuhën angleze, të paktën tre ditë para mbajtjes së seancës plenare për diskutimin dhe votimin e projektligjit në fjalë.

#### **2.1.4. Faza e Gazetës Zyrtare**

Pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe dekretimit nga Presidenti i Kosovës, ligji i procedohet për botim Zyrës për botimin e Gazetës Zyrtare (ZBGZ).<sup>49</sup> Ligjet hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit të tyre në Gazetën Zyrtare, përveç rasteve kur vetë ligji e përcakton ndryshe.

##### *Praktika e përkthimit*

ZBGZ-së i dorëzohet për botim akti ligjor i cili tashmë është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Si rrjedhojë, ZBGZ ka autoritet të kufizuar dhe nuk është kompetente për të rishikuar cilësinë për nga aspekti gjuhësor të versioneve në gjuhë të ndryshme të tekstit ligjor të miratuar. Prandaj ZBGZ mund të korrigjojë vetëm gabime daktilografie dhe drejtshkrimore të vogla, pas konsultimit me Kuvendin e Kosovës.

Gazeta Zyrtare e Kosovës botohet në gjuhën shqipe, serbe, angleze, turke dhe boshnjake.<sup>50</sup> ZBGZ është përgjegjëse për sigurimin e përkthimit të tekstit ligjor në gjuhët turke dhe boshnjake.<sup>51</sup>

#### **2.1.5. Procesverbalet e Kuvendit – mjet për interpretim të mirëfilltë në rastet e mospërputhjes në mes të versioneve në gjuhë të ndryshme të legjislacionit**

Sipas parimit të ligjshmërisë, është e domosdoshme që versionet në gjuhë të ndryshme e të njëjtit akt ligjor të përkojnë në tërësinë e tyre. Mospërputhjet në mes të versioneve në gjuhë të ndryshme të të njëjtit akt ligjor duhet të shmangen me çdo çmim. Kjo, në veçanti, është e rëndësishme për versionet në gjuhët zyrtare (shqip dhe serbisht) të cilat janë të barasvlershme.<sup>52</sup> Në këtë drejtim, Ligji për Gazetën Zyrtare parasheh që në rastet e mospërputhjeve midis versioneve të dokumenteve të ndryshme të botuara në Gazetën Zyrtare,

<sup>48</sup> Që prej deklarimit të njëanshëm të pavarësisë, përkthimi në shqip dhe anglisht financohet nga Zyra Civile Ndërkombëtare; më parë, përkthimi në gjuhën angleze është siguruar nga UNMIK-u.

<sup>49</sup> ZBGZ u themelua me Ligjin nr. 03/L-190 për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës të datës 4 qershor 2010; mandati i saj është shumë i ngjashëm me atë të Zyrës për menaxhimin dhe administrimin e Gazetës Zyrtare sipas Ligjit nr. 2004/47 për Gazetën Zyrtare.

<sup>50</sup> Shih nenin 5 të Ligjit nr. 03/L-190 për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës që ka hyrë në fuqi më 4 gusht 2010.

<sup>51</sup> Përkthimi në gjuhët turke bëhet nga përkthyesit e punësuar; përkthimin në gjuhën boshnjake e bën një kompani përkthimesh e kontraktuar.

<sup>52</sup> Shih nenin 5(4) të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

versionet në gjuhët zyrtare janë të barasvlershme.<sup>53</sup> Prandaj, në rastet kur ka mospërputhje midis versioneve në gjuhë të ndryshme të të njëjtit ligj, vullneti i vërtetë i legjislativit mbetet subjekt interpretimi.

Një mënyrë për të konstatuar me sukses vullnetin e vërtetë të legjislativit në rastet e mospërputhjeve në mes të versioneve në gjuhë të ndryshme, ndonëse të barasvlershme, të të njëjtit ligj është shqyrtimi i procesverbaleve të diskutimeve<sup>54</sup> gjatë seancës plenare së Kuvendit të Kosovës ose takimeve të komisioneve parlamentare për ligjin në fjalë. Procesverbalet e diskutimeve plenare ose të komisioneve nuk kanë karakter juridik, mirëpo mund të shërbejnë si një mjet i dobishëm për të analizuar ose identifikuar, përmes interpretimit teleologjik<sup>55</sup>, vullnetin e vërtetë të Kuvendit me rastin e aprovimit të ligjit. Edhe pse shpeshherë deputetët e Kuvendit shpeshherë nuk e diskutojnë tekstin paragraf për paragraf, procesverbalet gjithëpërfshirëse konsiderohen si mjet shumë i dobishëm për të shmangur keqinterpretimet, madje edhe interpretimet kundërthënëse nga gjyqësori dhe institucionet e tjera.

### 2.1.6. Përkthimi i legjislacionit dytësor

Në praktikë, legjislacioni parësor vendos parimet dhe rregullat e përgjithshme që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e subjekteve juridike ose personave fizikë për një fushë të caktuar. Në këtë mënyrë, legjislacioni parësor përkufizon kuadrin e gjerë të rregullimit të një çështjeje të caktuar, ndërsa dispozitat e tij zakonisht obligojnë degën e ekzekutivit që t'i zbatojë ato përmes legjislacionit dytësor.

Sipas parimit të hierarkisë së normave, çdo normë ligjore rrjedh nga një normë më e lartë dhe duhet të jetë në përputhje me atë. Në këtë kontekst, çdo pjesë e legjislacionit dytësor duhet ta ketë bazën e tij ligjore në një ligj ekzistues. Vendimet, udhëzimet administrative dhe rregulloret e nevojshme për zbatimin e ligjeve që i nxjerrin institucionet e Kosovës mund të konsiderohen si shembuj të legjislacionit dytësor.<sup>56</sup>

Siç u përmend më herët, korniza ligjore e Kosovës parasheh që legjislacioni parësor të botohet në pesë gjuhë<sup>57</sup>, ndërsa një dispozitë e këtillë nuk ekziston për legjislacion dytësor. Zakonisht, legjislacioni dytësor përkthehet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Mirëpo OSBE-ja ka vërejtur që në disa raste udhëzimet administrative kanë qenë në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe.<sup>58</sup>

<sup>53</sup> Shih nenin 3(2) të Ligjit nr. 2004/7 për Gazetën Zyrtare.

<sup>54</sup> Gjithashtu quhet *Travaux Préparatoires*.

<sup>55</sup> Përmes interpretimit teleologjik shtjellohen qëllimet e Kuvendit me rastin e miratimit të një akti ligjor. Ky interpretim shërben për të mbuluar zbrazëtitë të cilat do të mund të ekzistonin në rendin juridik dhe për të parandaluar pasojat e papranueshme që mund të rezultojnë nga interpretimi i fjalëpërfjalshëm i legjislacionit.

<sup>56</sup> Lista e akteve nënligjore të Qeverisë mund të gjendet në nenin 4(3) e Rregullores së punës së Qeverisë.

<sup>57</sup> Gjuha shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe angleze; shih shënimin 8, *supra*.

<sup>58</sup> Kjo është vërejtur në disa udhëzime administrative të Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Shih Udhëzimin Administrativ të MD-së nr. 152-126/2009 për "Programin dhe mbajtjen e provimit të jurisprudencës" dhe Udhëzimin Administrativ të MASHT-it nr. 1/2011 për "Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë".

## 2.2. Projekt-legjislacioni në nivelin lokal

Në këtë pjesë është pasqyruar procesi i hartimit të legjislacionit shumëgjuhësh në nivelin lokal, në bazë të të dhënave mbi praktikën dhe përvojën e palëve përkatëse të interesit në zbatimin e legjislacionit në versionet e tij në gjuhë të ndryshme. Vlerësimi i paraqitur pasqyron rezultatet e intervistave të strukturuar me zyrtarë të ndryshëm komunalë të cilat janë të angazhuar në procesin e hartimit dhe të zbatimit të legjislacionit shumëgjuhësh.<sup>59</sup>

### 2.2.1. Pasqyrë e përgjithshme

Komunat përfaqësojnë njësitë themelore të vetëqeverisjes lokale në Kosovë.<sup>60</sup> Korniza ligjore parasheh një nivel të lartë të vetë-rregullimit komunal. Komunat gëzojnë të drejtën që të nxjerrin akte ligjore për rregullimin e çështjeve që janë nën përgjegjësinë e tyre.<sup>61</sup> Pavarësisht nivelit të konsiderueshëm të pavarësisë institucionale të komunave, aktet ligjore që i nxjerrin ato duhet që të jenë në përputhje me kornizën ligjore të nivelit qendror në të gjithë aspektet.<sup>62</sup>

Bazuar në parimin themelor të barazisë së të gjitha komuniteteve, organet komunale bartin përgjegjësinë që të sigurojnë që të gjithë banorët e komunës t'i gëzojnë të drejtat e tyre pa kurrfarë dallimesh.<sup>63</sup> Kjo gjithashtu përfshin edhe përdorimin e gjuhës si një nga tiparet themelore të një komuniteti. Siç u përmend më sipër, gjuhët zyrtare të komunave gëzojnë një status të barabartë me gjuhët e tjera zyrtare të Kosovës.<sup>64</sup>

### 2.2.2. Procesi i hartimit të legjislacionit komunal

Institucionet e nivelit qendror u ofrojnë komunave udhëzime zyrtare të pakta rreth mënyrës së hartimit të akteve ligjore komunale. Nuk ka as kërkesa precize dhe të qarta për hartimin e akteve ligjore dhe as përcaktim të qartë të autoritetit përgjegjës për hartimin e legjislacionit.<sup>65</sup>

<sup>59</sup> Këtu përfshihen komunat e Deçanit/Deçane, Dragashit/Dragas, Ferizajt/Uroševac, Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Gjakovës/Đakovica, Gjilanit/Gnjilane, Glogocit/Glogovac, Graçanicës/Graçanicë, Hanit të Elezit/Đeneral Janković, Istogut/Istok, Junikut, Kaçanikut/Kaçanik, Klokot/Kllokotit, Kamenicës/Kamenica, Klinës/Klina, Lipjanit/Lipljan, Malishevës/Mališevo, Mamuşa/Mamushës/Mamuša, Mitrovicës/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërdës, Obiliqit/Obilić, Pejës/Peć, Podujevës/Podujevo, Prishtinës/Priština, Prizrenit, Rahovecit/Orahovac, Ranilug/Ranillugut, Shtimës/Štimlje, Skënderajt/Srbica, Štrpce/Shtërpçës, Suharekës/Suva Reka, Vitisë/Vitina dhe Vushtrrisë/Vučitrn.

<sup>60</sup> Shih nenet 3 dhe 4(1) të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, 19.06.2008. Gjithashtu, shih Kapitullin 1(1.3) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë dhe nenet 12 dhe 124 të kushtetutës.

<sup>61</sup> Shih nenin 12 të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Gjithashtu, neni 40(2) i Ligjit për vetëqeverisje lokale përcakton që Kuvendi Komunal nuk mund t'i delegojë përgjegjësitë e tij lidhur me nxjerrjen e akteve komunale të përgjithshme. Si rrjedhim, Kuvendi Komunal është organ legjislativ në nivelin lokal.

<sup>62</sup> Shih nenet 11 dhe 16 të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe nenin 124(6) e kushtetutës.

<sup>63</sup> Shih nenin 4(2) të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

<sup>64</sup> Shih nenin 2(3) të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Shih shënimet 6 dhe 7, *supra*.

<sup>65</sup> Gjatë një punëtorie për ngritjen e cilësisë së akteve komunale (iniciativë e përkrahur nga OSBE e mbajtur gjatë periudhës 27 shkurt–1 mars 2011), MAPL dhe zyrtarë të nivelit lokal raportuan që MAPL është në proces të hartimit të “Udhëzimeve për teknikat e hartimit ligjor të akteve komunale” që planifikohet të finalizohet deri në fund të vitit 2011. Gjithashtu gjatë vitit 2011, MAPL do të aprovojë një Udhëzim Administrativ për “Dorëzimin, shqyrtimin dhe mënyrat e adresimit të akteve komunale”. Gjersa drafti i udhëzimeve është në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, drafti i Udhëzimit Administrativ është në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe.

Në procesin e inicimit dhe të hartimit të akteve ligjore komunale janë të përfshirë një numër aktorësh. Përgjithësisht, organi që merr nismën e hartimit të akteve ligjore komunale është drejtoria komunale, veprimtaria e së cilës është e ndërlidhur me tematikën e aktit, zakonisht në bashkëpunim me zyrën ligjore të komunës.<sup>66</sup> Në disa raste, përveç drejtorive, nismën për legjislacion të ri e ndërmer Kryetari i Komunës<sup>67</sup>, Kryesuesi i Kuvendit Komunal<sup>68</sup> ose anëtarët e Kuvendit Komunal<sup>69</sup>. Në disa raste të tjera, hartues ose bashkëhartues i versionit fillestar të aktit ligjor komunal mund të jetë ndonjë komision<sup>70</sup>, komitet<sup>71</sup> ose grup punues<sup>72</sup>.

Pasi të jetë përgatitur drafti i parë, ai i dorëzohet për diskutim Kryetarit të komunës dhe drejtorisë(ve) komunale përkatëse. Me qëllim të fuqizimit të transparencës së organeve legjislative të komunës dhe të rritjes së nivelit të pjesëmarrjes së publikut në çështjet publike të komunës, të gjithë draftet e akteve duhet t'i nënshtrohen debatit publik. Qasja në përkthimet e këtyre akteve në gjuhë të tjera e lehtëson pjesëmarrjen e komuniteteve të ndryshme në procesin e hartimit të legjislacionit komunal. Pas përfshirjes së komenteve të dhëna gjatë debatit publik, draftin e aktit ligjor e shqyrton Komiteti për Politika dhe Financa dhe më pas ai i dorëzohet Kuvendit Komunal për aprovim.

Gjatë këtij procesi, pjesëmarrja efektive e komuniteteve joshumicë<sup>73</sup> në proceset e vendimmarrjes është thelbësore. Në këtë kontekst, komunitetet joshumicë kanë përfaqësues të përhershëm në strukturat komunale, duke përfshirë këtu Zëvendëskryesuesin për Komunitete<sup>74</sup>, Zëvendëskryetarin për Komunitete<sup>75</sup>, Zyrën Komunale për Komunitete ose Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim<sup>76</sup> dhe Komitetin për Komunitete<sup>77</sup>. Të gjitha

<sup>66</sup> Kjo është vërejtur në komunat e Dragashit/Dragaš, Gjakovës/Đakovica, Gjilanit/Gnjilane, Glllogocit/Glogovac, Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Junikut (ku nismën për aktin ligjor e merr drejtoria komunale përkatëse, por inspektori sanitar është i vetmi anëtar i stafit që harton rregullore komunale), Kaçanikut/Kaçanik, Mamuşa/Mamushës/Mamuša, Mitrovicës/Mitrovica, Pejës/Peć, Prizrenit, Prishtinës/Priština, Podujevës/Podujevo, Rahovecit/Orahovac (ku aktorët iniciues ndryshojnë në varësi të llojit dhe natyrës së legjislacionit komunal; në përgjithësi, drejtoritë përkatëse komunale dhe Kryetari i komunës janë aktorët përgjegjës), Ranilug/Ranillugut, Shtimes/Štimlje, Skenderajt/Srbica, Štrpce/Shtërpçes (ku Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme në bashkëpunim me Kryetarin e komunës inicion hartimin e akteve ligjore), Suharekës/Suva Reka dhe Vushtrrisë/Vučitrn.

<sup>67</sup> Kjo është vërejtur në komunat e Gračanica/Graçanicës, Klokot/Kllokotit, Lipjanit/Lipljan, Novo Brdo/Novobërdës dhe Vitisë/Vitina.

<sup>68</sup> Kjo është vërejtur në komunën e Ferizajt/Uroševac.

<sup>69</sup> Kjo është vërejtur në Kamenicë/Kamenica ku hartimin e akteve ligjore e inicion edhe Zyra Ligjore krahas zyrtarëve komunalë të tjerë.

<sup>70</sup> Kjo është vërejtur në disa komuna, duke përfshirë këtu Hanin e Elezit/Đeneral Janković, ku Zyrtari Ligjor i komunës dhe ekspertët e jashtëm janë anëtarë të këtij komisioni. Në Istog/Istok nismën mund ta ndërmer Kryetari, Kryesuesi dhe anëtarët e kuvendit komunal, si dhe drejtoria komunale përkatëse. Në raste të tilla, me kërkesë të Kryetarit të komunës, themelohet një komision për hartimin e draftit fillestar të legjislacionit komunal. Në komunën e Malishevës/Mališevo nuk ekziston ndonjë rregull standard. Ndonjëherë iniciues është këshilltari ligjor i Kryetarit të komunës. Në komunat e Mitrovicës/Mitrovica, Skenderajt/Srbica dhe Vushtrrisë/Vučitrn përgjegjës për hartimin e legjislacionit komunal është Komiteti funksional i komunës.

<sup>71</sup> Kjo është vërejtur në komunën e Deçanit/Dečane, ku nismën për legjislacion e merr Komiteti funksional komunal ose drejtoria komunale përkatëse.

<sup>72</sup> Kjo është vërejtur në komunën e Klinës/Klina, ku komuna raporton që grupi punues zakonisht përbëhet nga Kryetari, drejtorët e drejtorive komunale, zyrtari ligjor, zyrtari komunal për komunitete, një numër i kuvendarëve dhe përfaqësuesish të shoqërisë civile.

<sup>73</sup> Për qëllimet e këtij raporti, termi komunitet joshumicë i referohet çdo komuniteti që është numerikisht pakicë në nivelin komunal.

<sup>74</sup> Shih nenin 54 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

<sup>75</sup> Shih nenin 61 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

<sup>76</sup> Zyrtat Komunale për Komunitete (ZKK) fillimisht u themeluan sipas Rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, të 11 gushtit 2000, dhe ndryshimet e plotësimet e mëvonshme me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/30 të 16 tetorit 2007. Ligji për vetëqeverisje lokale nuk parashihte



këto organe, në kuadër të mandateve përkatëse të tyre, avokojnë dhe mbrojnë interesat e komunitetit ose komuniteteve pakicë në komunën e tyre. Ky mekanizëm siguron përfshirjen aktive të komuniteteve në të gjitha çështjet publike, duke përfshirë këtu edhe hartimin e legjislacionit komunal.

Mirëpo, rezultatet e dala nga intervista tregojnë se në vitin 2010, përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë merrnin pjesë në procesin e hartimit të legjislacionit komunal vetëm në gjashtë komuna.<sup>78</sup> Në shumicën e komunave, përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë nuk angazhohen në procesin e hartimit të legjislacionit komunal.<sup>79</sup> Zyrtarët e këtyre komunave e arsyetojnë këtë fakt duke deklaruar që vetëm një numër i pakët i anëtarëve të komuniteteve pakicë janë banorë të komunave përkatëse. Në komunat e tjera, angazhimi i përfaqësuesve të komuniteteve pakicë në procesin e hartimit të legjislacionit është i kufizuar (p.sh. vetëm përkritazi me legjislacionin me ndikim për komunitetet ose detyrat e përkthimit dhe lektorimit).<sup>80</sup>

---

obligimin për krijimin e këtyre zyrave si një mekanizëm komunal, që do të thotë se jo që të gjitha komunat i themeluan ZKK. Më 12 gusht 2008, qeveria e Kosovës nxori Rregulloren nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim me të cilën përcaktohet që të gjitha komunat të themelojnë Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK). ZKKK-të kanë zëvendësuar ZKK-të në komunat ku këto të fundit kanë ekzistuar më parë, si dhe po kryejnë funksionet e veta bashkë me një fushëveprim të zgjeruar të kompetencave. Në disa komuna, si Mitrovica/Mitrovica, ZKK-të janë ende funksionale, derisa në disa tjera, personat kontaktues për komunitete dhe kthim emërohen nga Kryetari i Komunës (Kaçanik/Kaçanik; Gračanica/Graçanicë; Malishevë/Mališevo). Procesi i shuarjes së ZKK-ve dhe i themelimit të ZKKK-ve ka qenë në vazhdim e sipër gjatë kohës së përgatitjes së këtij raporti dhe intervistat me zyrtarët e ZKK-ve janë mbajtur para këtyre zhvillimeve.

<sup>77</sup> Shih nenin 53 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

<sup>78</sup> Në kuadër të këtyre komunave ishin të përfshira komuna e Pejës/Peć (ZKK, Zëvendëskryesuesi për Komunitete dhe Zëvendëskryetari për Komunitete ishin të përfshirë në proces, por gjatë intervistave këta aktorë kanë treguar që angazhimi i tyre nuk ka qenë i qëndrueshëm dhe se ka nevojë për përmirësim), Istogut/Istok (pjesëmarrja e ZKK), Klokot/ =Kllkotit (të përfshirë ishin Zëvendëskryesuesi për Komunitete dhe Zëvendëskryetari për Komunitete, por ZKK ende nuk ishte themeluar), Novo Brdo/Novobërdës (Zëvendëskryetari për Komunitete dhe Zëvendëskryesuesi për Komunitete), Prishtinës/Priština (Zëvendëskryesuesi për Komunitete), Ranilug/Ranillugut (Zëvendëskryetari për Komunitete), Mitrovicës/Mitrovica (Zëvendëskryesuesi për Komunitete dhe Zëvendëskryetari për Komunitete janë të angazhuar në fazën e Kuvendit Komunal).

<sup>79</sup> Kjo është vërejtur në komunën e Gjakovës/Đakovica (sipas rezultateve të intervistës, Udhëheqësi i ZKK-së ishte i angazhuar në procesin e hartimit të legjislacionit prej 2004 deri në 2007), Gllgocit/Glogovac (në kohën e mbajtjes së intervistës, përfaqësuesit e komuniteteve ende nuk ishin emëruar), Obiliqit/Obilić, Klinë/Klina (edhe pse Zyrtarët Ligjorë të këtyre komunave raportuan që ZKK merr pjesë në procesin e hartimit të legjislacionit komunal, informata nuk u konfirmua nga Zyrtari për Komunitete dhe Kthim), Gračanica/Graçanicës (në kohën e mbajtjes së intervistës nuk ekzistonte pozita e Zëvendëskryetarit për Komunitete. Gjithashtu nuk ishin të angazhuar as ZKK dhe Zëvendëskryesuesi për Komunitete), Malishevës/Mališevo (në kohën e mbajtjes së intervistës, në këtë komunë nuk ekzistonin pozita për përfaqësimin e komuniteteve. Gjithashtu, Zyrtari për Komunitete i komunës nuk ishte i angazhuar në procesin e hartimit të legjislacionit komunal), Prizrenit (Zëvendëskryesuesi për Komunitete dhe Zëvendëskryetari për Komunitete ende nuk ishin emëruar në kohën e mbajtjes së intervistës), Podujevës/Podujevo (përfaqësuesit e komuniteteve nuk ishin të emëruar në kohën e mbajtjes së intervistës), Dragashit/Dragaš, Rahovecit/Orahovac (pozita e Zëvendëskryesuesit për Komunitete nuk ishte e krijuar në kohën e mbajtjes së intervistës), Suharekës/Suva Reka, Vushtrisë/Vučitrn, Ferizajt/Uroševac, Gjilanit/Gnjilane, Kamenicës/Kamenica, Hanit të Elezit/Đeneral Janković, Vitisë/Vitina, Kaçanikut/Kaçanik (në këtë komunë pozitat e përfaqësuesve të komuniteteve nuk ishin krijuar gjatë kohës së kryerjes së intervistës) dhe Junikut (pozitat e përfaqësuesve të komuniteteve nuk ishin krijuar gjatë kohës së kryerjes së intervistës).

<sup>80</sup> Kjo është vërejtur në komunat e Fushë Kosovës/Kosovo Polje (ZKK dhe Kryesuesi i Komitetit për Komunitete), Lipjanit/Lipljan (Komiteti për Komunitete dhe ZKK), Mamuša/Mamushës/Mamuša (Zëvendëskryetari për Komunitete), Mitrovicës/Mitrovica (ZKK dhe Komiteti për Komunitete),

Sipas kornizës ligjore, të gjitha aktet normative komunale duhet të procedohen, të miratohen dhe të botohen në gjuhët zyrtare të komunës.<sup>81</sup> Të gjitha versionet në gjuhët zyrtare të legjislacionit komunal janë të barasvlershme.<sup>82</sup> Prandaj, komunat kanë për obligim të respektojnë statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare, pavarësisht përbërjes demografike të komuniteteve që jetojnë në atë komunë. Me fjalë të tjera, edhe ato komuna në të cilat jeton vetëm një numër i vogël i komuniteteve pakicë janë prapëseprapë të obliguara që ta procedojnë dhe ta nxjerrin legjislacionin e tyre në gjuhën shqipe dhe serbe.

Në rastet kur gjuha e komunitetit pakicë gëzon statusin e gjuhës zyrtare në një komunë, mungesa e projekt-legjislacionit të përkthyer apo dështimi në të siguruarit të një cilësie adekuate të përkthimit përbën shkëlqje të statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare. Kjo është gjithashtu një pengesë tjetër për pjesëmarrjen efektive dhe efikase të komuniteteve pakicë në procesin e hartimit të legjislacionit komunal. Si rrjedhojë kemi dobësimin e mekanizmit gjithëpërfshirës (p.sh. qasja në drejtësi ose mjeti juridik efektiv) për mbrojtjen e komuniteteve pakicë.

### *Praktika e përkthimit*

Vlerësimi mes zyrtarëve komunalë përgjithësisht vërteton që 17 komuna<sup>83</sup> përpunojnë dhe miratojnë projekt-ligjet dhe rregulloret e tyre në gjitha gjuhët zyrtare. Kohët precize të përkthimit të projekt-akteve ligjore dallojnë nga komuna në komunë. Në disa raste, kjo gjë bëhet qysh në fazë fillestare, para se drafti i parë t'i dorëzohet degës ekzekutive për diskutim.<sup>84</sup> Në komuna tjera, përkthimi i tekstit bëhet para procesit të konsultimeve publike<sup>85</sup>, para shqyrtimit të tij në komisione të kuvendit komunal<sup>86</sup>, apo para parashtrimit përfundimtar tek Kuvendi i Komunës për miratim<sup>87</sup>. Tetë komuna sigurojnë përkthimin e legjislacionit në gjuhën serbe vetëm pas miratimit të aktit ligjor nga kuvendi i komunës.<sup>88</sup> Përfundimisht, 11 komuna rregullisht shpallin legjislacionin e tyre vetëm në gjuhën e komunitetit shumicë.<sup>89</sup> Në

---

Skenderajt/Srbica (ZKK), Novo Brdo/Novobërdës (ZKK), Shtimes/Štimlje (ZKK) dhe Štrpce/Shtërpçës (Zëvendëskryetari për Komunitete).

<sup>81</sup> Paragrafi 6 i nenit 7 të Ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve.

<sup>82</sup> Neni 7(6) i Ligjit për përdorimin e gjuhëve; shih listën e gjuhëve zyrtare në Kapitullin I.

<sup>83</sup> Kjo është vërejtur në Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Gračanica/Graçanicë, Istog/Istok, Klokot/Klokot, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan, Novobërdë/Novo Brdo, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Ranilug/Ranillug, Skenderaj/Srbica dhe Štrpce/Shtërpçë.

<sup>84</sup> Kjo është vërejtur në Klokot/Klokot, Novobërdë/Novo Brdo, Ranilug/Ranillug, Štrpce/Shtërpçë, Dragash/Dragaš, Istog/Istok dhe Klinë/Klina.

<sup>85</sup> Kjo është vërejtur në komunat: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Skenderaj/Srbica, Podujevë/Podujevo, dhe Prishtinë/Priština.

<sup>86</sup> Kjo është vërejtur në komunat Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Gračanica/Graçanicë, Obiliq/Obilić dhe Prizren.

<sup>87</sup> Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë/Mitrovica (ku nuk mbahet debat publik). Në komunën e Lipjanit/Lipljan, çështja nëse përkthimi bëhet para apo pas miratimit të tekstit nga Kuvendi i Komunës varet nga ngarkesa e punës.

<sup>88</sup> Kjo është vërejtur në komunat: Ferizaj/Uroševac, Kaçanik/Kaçanik, Viti/Vitina, Rahovec/Orahovac, Vushtrri/Vučitrn, Pejë/Peć (ofrohet edhe përkthimi në boshnjakisht); Suharekë/Suva Reka dhe Deçan/Dečane (përkthimi jo gjithmonë ofrohet. Vetëm 30% e gjithë dokumentacionit zyrtar është përkthyer nga komuna deri tani).

<sup>89</sup> Kjo është vërejtur në komunat: Shtime/Štimlje, Glogovac/Glogovac, Hani i Elezit/Đeneral Janković, Malishevë/Mališevo, Gjakovë/Đakovica, Junik, Mitrovicë/Mitrovica, Mamuša/Mamushë/Mamuša (nuk ofrohet përkthim në serbisht; përkthimi në turqisht sigurohet në fazën fillestare), Leposavić/Leposaviq–Zubin Potok–Zvečan/Zvečan (këto komuna funksionojnë sipas Ligjit të Serbisë për

disa raste, vetëm legjislacioni që konsiderohet i rëndësishëm nga komuna, si statuti komunal apo legjislacioni që ka të bëjë drejtpërdrejt me çështjet e komunitetit, është ai që përkthehet. Në disa nga këto komuna, zyrtarët komunalë të intervistuar kanë theksuar që përkthimi i legjislacionit lokal apo cilitdo dokument tjetër zyrtar ofrohet në bazë të kërkesës.<sup>90</sup>

Për më tepër, rezultatet e sondazhit tregojnë që tetë komuna të Kosovës nuk kanë parë nevojën për legjislacion në shumë gjuhë në territorin e tyre.<sup>91</sup> Por, të tetë komunat e konfirmojnë vetëdijen e tyre për obligimet ligjore ekzistuese në lidhje me përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare. Prapë, argumenti kryesor është përbërja kryesisht një-etnike, si dhe, tjetri, integrimi gjuhësor i anëtarëve të komunitetit jo-shumicë. Zyrtarët në këto komuna më tutje i arsyetojnë këto duke përmendur mungesën e burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe kushtet e dobëta të punës.<sup>92</sup>

Vlerësimi gjithashtu tregon që në kohën e intervistimit, nuk ka pasur njësi përkthimi të themeluara në gjashtë komuna.<sup>93</sup> Në raste të tilla, zyrtarët komunalë, të cilët nuk janë përkthyes si dhe nuk kanë prapavijën e duhur arsimore dhe profesionale, bëjnë përkthimet kurdo që është nevoja.<sup>94</sup> Ky fleksibilitet dhe vullnet i disa zyrtarëve për të kryer detyra përtej fushëveprimit dhe përshkrimit të tyre të punës do të mund të vlerësohej pozitivisht. Megjithatë, një shembull i tillë, përkundër demonstrimit të vullnetit dhe përpjekjeve nga ana e zyrtarëve komunalë për të mbuluar mungesat ekzistuese, nuk mund të konsiderohet të jetë zgjidhje afatgjate, pasi që paraqet vetëm përgjigje të atypëratyshme, si dhe nuk e trajton problemin strukturor si të tillë.

Në pjesën veriore të Kosovës, komunat Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçan nuk zbatojnë legjislacionin e Kosovës.<sup>95</sup> Këto komuna shfrytëzojnë shërbimet e përkthyesve të UNMIK-ut, të cilët përkthejnë dokumente dhe rregullore. Kërkesat për përkthim më shpesh vijnë nga vetë personeli i UNMIK-ut që punon në ato komuna, e shumë rrallë nga vetë anëtarët e komunitetit shqiptar. Megjithatë, ekipet e OSBE-së në terren nuk kanë mundur të konfirmojnë asnjë përkthim të rregulloreve komunale në gjuhën shqipe mes viteve 2008 dhe 2010 në këto komuna. Një problem i ngjashëm ekziston edhe në komunën e Mitrovicës/Mitrovica, ku raportohet që përkthyesi i komunës ka marrë për detyrë nga autoritetet komunale të përkthejë vetëm dy rregullore komunale në gjuhën serbe qysh prej vitit 2006, për shkak të mungesës së kërkesave nga komuniteti serb.

Institucionet lokale mbajnë përgjegjësinë e sigurimit të përkthimit adekuat në gjitha gjuhët zyrtare. Kjo mund të garantohet vetëm nëse punësohet apo kontraktohet prej së jashtmi

---

Vetë-Qeverisje Lokale. Përkthimi në gjuhë tjera sigurohet nga UNMIK-u sipas kërkesës. Megjithatë, nuk ka qenë e mundur të vërtetohet nëse ka pasur ndonjë përkthim në dy vitet e fundit).

<sup>90</sup> Kjo është vërejtur në komunat: Gjakovë/Đakovica, Shtime/Štimlje dhe Glogovc/Glogovac.

<sup>91</sup> Kjo është vërejtur në Gjakovë/Đakovica, Deçan/Dečane, Shtime/Štimlje, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Malishevë/Mališevo, Suharekë/Suva Reka, Hani i Elezit/Đeneral Janković dhe Kaçanik/Kaçanik.

<sup>92</sup> Kjo është vërejtur në Deçan/Dečane, Glogovc/Glogovac, Hani i Elezit/Đeneral Janković, Rahovec/Orahovac dhe Prishtinë/Priština, të cilat përmendin kushtet e këqija të punës dhe mungesën e pajisjeve të përkthimit si sfida më të cilën përballen gjatë përkthimit.

<sup>93</sup> Kjo gjë është shënuar në komunat: Shtime/Štimlje, Obiliq/Obilić, Glogovc/Glogovac, Malishevë/Mališevo, Hani i Elezit/Đeneral Janković dhe Junik municipalities (Leposavic/Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan / Zveçan janë përjashtuar nga studimi në këtë kuptim).

<sup>94</sup> Kjo gjë është shënuar në komunat: Shtime/Štimlje, Obiliq/Obilić, Suharekë/Suva Reka dhe Gjakovë/Đakovica (aktet e fundit ligjore të shtypura dhe të botuara në shqip dhe serbisht kanë qenë Statuti Komunal dhe rregulloret e miratuara më 2007).

<sup>95</sup> Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë, e cila zbaton Rregulloret e UNMIK-ut, ka dy përkthyes për shqip dhe serbisht.

personeli i kualifikuar e përgjegjës për shërbime përkthimi, për të ofruar përkthim të mirëfilltë dhe me kohë. Shpallja e legjislacionit komunal në vetëm një nga gjuhët zyrtare, si dhe vetëm pas miratimit të tij, është qartësisht mospërbushje e një prej obligimeve të përcaktuara me kornizën ligjore. Një praktikë e tillë kontribuon në përjashtimin e anëtarëve të komuniteteve joshumicë nga çështjet publike, duke vështirësuar kështu edhe integrimin e tyre në shoqërinë e Kosovës. Kështu, gjitha komunat, pa marrë parasysh përbërjen demografike, inkurajohen fuqimisht që të respektojnë statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare, si dhe të shpallin gjitha aktet normative në gjitha gjuhët zyrtare.

### 2.3. Rritja e cilësisë së legjislacionit shumë-gjuhësh

Komunat përballen me vështirësi substanciale në përbushjen e obligimeve të tyre të cilat rrjedhin nga sistemi i legjislacionit shumë-gjuhësh, duke përfshirë edhe mungesën e burimeve njerëzore, teknike dhe buxhetore, përveç mbingarkesës së vazhdueshme me punë.<sup>96</sup> Për më tepër, përkthyesit komunalë shpesh nuk kanë kualifikimet dhe përvojën adekuate. Kjo përbën një pengesë sidomos kur bëhet fjalë për terminologjinë juridike; është raportuar që përkthyesit komunalë që nuk kanë përvojë me përkthimet juridike kanë vështirësi në këto detyra. Kjo shpesh rezulton në zbatim të pasaktë apo të papërputhshëm të termave juridikë.<sup>97</sup> Megjithatë, është tejet e vështirë të punësohen anëtarë personeli më të kualifikuar dhe me më shumë përvojë kur merren parasysh pagat e ulta dhe beneficionet në krahasim me punëtorët tjerë në Kosovë.<sup>98</sup> Përveç këtyre, disa njësi komunale përkthimi nuk ka as mjetet më themelore teknike për përkthyes, si fjalorë apo programe kompjuterike për drejtshkrim.<sup>99</sup> Zyrtarët e nivelit qendror përmendin vështirësi të ngjashme, si kufizimet njerëzore dhe buxhetore<sup>100</sup>, apo kualifikimet jo-adekuate të përkthyesve, që kryesisht çon në përdorim të terminologjisë së pasaktë<sup>101</sup>.

Një zgjidhje strukturore ndaj problemeve të lartpërmendura mund të gjendet tek përforsimi i rolit të Institutit Kosovar për Administratë Publike (IKAP). IKAP-i është themeluar si agjenci ekzekutive brenda Ministrisë së Administratës Publike (MAP) për të qenë institucioni primar i trajnimit, përgjegjës për trajnimin e përgjithshëm të shërbyesve civilë të Kosovës.<sup>102</sup> IKAP-i zbaton strategjinë e trajnimit për shërbimin civil të Kosovës, e cila hartohet nga MAP-i. Përveç kësaj, Instituti është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin periodik të kërkesave për trajnim nga shërbimi civil i Kosovës në nivelin qendror dhe atë lokal; bashkërendimin e aktiviteteve të trajnimit për shërbyesit civilë të Kosovës në bashkëpunim me komunat, si dhe institucionet tjera të Kosovës; hartimin e planeve strategjike afatmesme dhe afatgjata për një administratë efektive dhe efikase; si dhe për krijimin e një forumi diskutimesh në lidhje me hartimin e politikave të administratës publike. Në këtë kuptim, IKAP-i duhet të ketë rol

<sup>96</sup> Kjo gjë është shënuar në komunat: Pejë/Peć, Deçan/Dečane, Obiliq/Obilić, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Suharekë/Suva Reka, Dragash/Dragaš, Prizren, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Kamenicë/Kamenica, Kllokot/Klokot, Novobërdë/Novo Brdo, Ranilug/Ranillug dhe Štrpce/Shtërpçë.

<sup>97</sup> Kjo gjë është shënuar në komunat: Mamuša/Mamushë/Mamuša, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Novobërdë/Novo Brdo, Viti/Vitina dhe Pejë/Peć.

<sup>98</sup> Kjo gjë është shënuar në komunat: Pejë/Peć, Prizren, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Vushtrri/Vučitrn dhe Mitrovicë/Mitrovica.

<sup>99</sup> Kjo gjë është shënuar në komunat: Skenderaj/Srbica dhe Prishtinë/Priština.

<sup>100</sup> Kjo gjë është shënuar në MKK dhe MPB.

<sup>101</sup> Kjo gjë është shënuar në MD, MPB, si dhe në ZKM.

<sup>102</sup> Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2003/25 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetë-Qeverisjes në Kosovë.

kryesor në avancimin e shkathtësive të përkthyesve verbalë dhe me shkrim brenda shërbimit civil të Kosovës. Kështu, ai do të duhej të ofronte edhe trajnime profesionale për shkathtësi të avancuara të përkthimit me shkrim dhe me gojë, të cilat do të përfshinin edhe trajnime për tema të zgjedhura, si terminologjia juridike.<sup>103</sup>

Një sfidë tjetër e identifikuar është mungesa e një praktike të vendosur të lektorimit në nivelin qendror dhe atë lokal, një problem që prapë ndërlidhet me mungesat e përgjithshme të burimeve njerëzore e buxhetore. Lektorimi i referohet procesit të leximit të një teksti të shkruar për gjetjen e gabimeve sipërfaqësore, të cilat përfshijnë drejtshkrimin, pikëzimin, gramatikën apo përzgjedhjen e fjalëve. Veçanërisht, ky proces ndihmon në gjetjen dhe korrigjimin e gabimeve ortografike, gabimet e përkthimit në gramatikë, sintaksë apo terminologji, si dhe në shmangien e mospërputhjeve të mundshme në tekst para miratimit të legjislacionit.

Edhe pse përkthimet shpesh kontrollohen nga zyrtarët e departamenteve përkatëse ligjore<sup>104</sup>, praktika e lektorimit nuk është as kërkesë ligjore e parashikuar në mënyrë specifike e as praktikë e përdorur gjerësisht në institucionet e Kosovës në nivelin qendror, ashtu siç konfirmohet nga të intervistuarit në ministri të zgjedhura. Ngjashëm, nuk ka praktikë formale të lektorimit as në nivelin lokal<sup>105</sup>. Zyrtarët komunalë kanë shprehur mendimin që praktika e lektorimit duhet vendosur në gjitha komunat, si dhe që cilësia do të avancohej nëse do të praktikoheshin kjo gjë, me qëllim të rritjes së cilësisë së versioneve të legjislacionit në gjuhë të ndryshme.<sup>106</sup> Nevoja për praktikë të institucionalizuar lektorimi është vërtetuar edhe nga rezultatet e aktiviteteve të monitorimit nga OSBE-ja. Përmes aktiviteteve të veta të shqyrtimit legjislativ, OSBE-ja ka vërejtur që projektligjet dhe aktet tjera juridike shpesh kanë gabime ortografike, përveç gabimeve të përkthimit në gramatikë, sintaksë apo terminologji. Gabimet e tilla mund të krijojnë mospërputhje esenciale mes versioneve në gjuhë të ndryshme. Nëse nuk gjenden dhe nuk korrigjohen që në fazën e hartimit, këto gabime mund të çojnë në trajtimit të ndryshme të individëve pas miratimit dhe zbatimit të këtyre akteve juridike.

Dispozita në vijim shërben si shembull.

*Neni 25, paragrafi 2, projektligji për qasje në dokumente publike*<sup>107</sup>

Sipas versionit në gjuhën shqipe, është parashikuar gjoba prej “1000 Eurosh” si dënim.<sup>108</sup> Megjithatë, versionin në serbisht parashikon gjobën prej “100 Eurosh”.<sup>109</sup>

<sup>103</sup> Mes 29 nëntorit dhe 17 dhjetorit 2010, OSBE-ja ka financuar dhe ka ofruar, në bashkëpunim me IKAP-in, një trajnim intensiv për 32 përkthyes me shkrim/me gojë për shkathtësi të gjuhës angleze dhe serbe, pasuar nga aftësi interpretimi.

<sup>104</sup> Kjo është shënuar në MD, MAP, MPMS, MPB, si dhe ZKM (kjo praktikë nuk vlen për MKK-në për shkak të praktikës së saj të bashkëhartimit në grupe pune).

<sup>105</sup> 12 komuna kanë theksuar që lektorimi është përgjegjësi formale e hartuesit të ligjit dhe përkthyesit: Gjakovë/Đakovica, Lipjan/Lipljan, Rahovec/Orahovac, Mitrovicë/Mitrovica, Hani i Elezit/Đeneral Janković, Kamenicë/Kamenica, Kllokot/Klokot, Novobërdë/Novo Brdo, Ranilug/Ranillug, Dragash/Dragaš, Kačanik/Kačanik dhe Štrpce/Shtërpçe; në 10 komuna, praktika e ndarë e lektorimit nuk është e vendosur; në Pejë/Peć (ku në veçanti ka pasur mospërputhje mes deklaratave të zyrtarëve të ndryshëm në kuptimin e ekzistencës së praktikës së lektorimit), Obiliq/Obilić, Gračanica/Gračanicë, Suharekë/Suva Reka, Ferizaj/Uroševac, Viti/Vitina, Deçan/Dečane, Administratën e UNMIK-ut në Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn dhe Istog/Istok; në komunat në vijim, lektorimi i ndarë bëhet në mënyrë joformale në raste të caktuara: në Klinë/Klina, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Prizren, Mamuša/Mamushë/Mamuša dhe Gjilan/Gnjilane

<sup>106</sup> Kjo është shënuar në komunat: Gjilan/Gnjilane, Ferizaj/Uroševac dhe Viti/Vitina.

<sup>107</sup> Ky projektligj ka hyrë në fuqi më 25 nëntor 2010 si Ligji nr. 03/L-215 mbi Qasjen ndaj Dokumenteve Publike.

Si rezultat i diskutimit në grupin punues ndërministror, mbështetur nga komentet e dhëna nga OSBE-ja, kjo dispozitë është ndryshuar. Më vonë, dispozita në lidhje me gjobat financiare është hequr. Siç ilustron me këtë shembull, vendosja apo përmirësimi i praktikës së lektorimit do të mund të ndihmonte në gjetjen dhe korrigjimin e gabimeve të mundshme të përkthimit, bashkë me gabimet ortografike, para se legjislacioni të hyjë në fuqi. Kjo do të kontribuonte në rritjen e cilësisë së akteve juridike në gjitha gjuhët e tyre.

### **3. LEGJISLACIONI SHUMË-GJUHËSH NË KOSOVË: LEGJISLACIONI NË FUQI**

Si rezultat i mangësive të identifikuar, legjislacioni shpesh miratohet dhe zbatohet me gabime gjuhësore. Gabimet e tilla shpesh krijojnë pengesa në punën e përditshme të zyrtarëve publikë, derisa individët dhe subjektet tjera të legjislacionit mund të ndikohen gjithashtu negativisht.

Ndikimi praktik i gabimeve gjuhësore në legjislacionin ekzistues është vlerësuar me anë të intervistave të strukturuar që janë bërë me palët e ndryshme në degët ekzekutive dhe gjyqësore.<sup>110</sup> Këta persona kanë përshkruar përvojat e tyre me sistemin legjislativ shumëgjuhësh në Kosovë, si e vlerësojnë cilësinë e versioneve të ndryshme gjuhësore të legjislacionit, si dhe nëse kanë pasur vështirësi në punën e tyre të cilat janë krijuar nga përkthimi i dobët apo i pasaktë i legjislacionit. Përmes aktiviteteve të shqyrtimit legjislativ, OSBE-ja ka identifikuar gabime gjuhësore në aktet ligjore të Kuvendit të Kosovës.

#### **3.1. Degët ekzekutive dhe ligjvënëse**

Në përgjithësi, zyrtarët komunalë janë të vetëdijshëm për praktikën e shpeshtë të përkthimeve të dobëta në legjislacionin qendror dhe atë lokal.<sup>111</sup> Mes gabimeve të raportuara janë kryesisht gabime gramatikore dhe përdorimi i fjalëve kroate dhe boshnjake në përkthimet e serbishtes.<sup>112</sup> Një nga zyrtarët ka shprehur qëndrimin që praktika e përkthimeve të dobëta në nivelin qendror i bën komunat më pak të prira të ngrenë standardet e tyre të përkthimit.

Intervistat gjithashtu kanë konfirmuar që zyrtarët komunalë që i përkasin komuniteteve jo-shqiptare janë më të brengosur për cilësinë e dobët të dokumenteve të përkthyer sesa

---

<sup>108</sup> Theksi i shtuar.

<sup>109</sup> Theksi i shtuar.

<sup>110</sup> Informatat në lidhje me përvojën e degës ekzekutive janë dhënë kryesisht nga përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë (p.sh. Zyrtarët komunalë të komuniteteve, Zëvendës Kryesuesit për Komunitete, apo Zëvendës Kryetarët për Komunitete), duke marrë parasysh që këta janë individët që kanë më së shumti mundësi të jenë në kontakt direkt me legjislacionin në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë. Nga gjyqësori, gjyqtarët, prokurorët dhe juristët nga rajonet e Prishtinës/Priština, Prizrenit dhe Mitrovicës/Mitrovica kanë ofruar të dhënat e rëndësishme për këtë raport.

<sup>111</sup> Kjo është vërejtur në komunat: Pejë/Peć, Klinë/Klina, Gjakovë/Dakovica, Obiliq/Obilić, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gračanica/Graçanicë, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka, Skenderaj/Srbica, Ferizaj/Uroševac, Kamenicë/Kamenica, Viti/Vitina dhe Obiliq/Obilić.

<sup>112</sup> Kjo është shënuar në komunën e Obiliqit/Obilić (Zyrtari komunal ligjor, Përkthyesi komunal/Zyrtari komunal i informimit, zëvendës Kryetari për Komunitete).

homologët e tyre që i përkasin komunitetit shumicë.<sup>113</sup> Në këtë kuptim, njëri nga zyrtarët ka theksuar që dështimi në përkthimin e legjislacionit në gjitha gjuhët zyrtare, apo cilësia e dobët e versioneve të caktuara gjuhësore, ndikon në përfshirjen e zyrtarëve të komuniteteve jo-shqiptarë në çështjet komunale.<sup>114</sup> Një zyrtar tjetër shprehimisht u deklarua që praktika e përkthimeve të dobëta kontribuon në huti e keqkuptime në punën e përditshme. Nevoja e kërkimit të qartësimeve dhe shpjegimeve të mëtutjeshme, si dhe nevoja për krahasim të versioneve të ndryshme gjuhësore i bën detyrat më kërkuese për kohën dhe më të vështira. Probleme tjera dalin nëse zyrtari nuk flet gjuhën tjetër zyrtare, si dhe në këtë mënyrë nuk mund të krahasojë lehtësisht versionin tjetër të legjislacionit.<sup>115</sup>

Shembujt në vijim ilustrojnë disa nga gabimet në përkthim që janë gjetur në legjislacion. Kjo përcillet me një elaborim të shkurtër mbi pasojat që janë shkaktuar apo që do të mund të shkaktoheshin.

### *Shembull*

P – 4.19, Përdorimi i prangave, I. Politika, *Manuali i Politikave dhe Procedurave i Policisë së Kosovës (versioni 2003)*<sup>116</sup>

Versioni në shqip përcakton që: “përdorimi i prangave është përdorim force, si dhe duhet arsyetuar sipas politikës së SHPK-së për përdorimin e forcës”;<sup>117</sup> derisa versioni në serbisht thotë: “përdorimi i prangave është përdorim force, kështu që ky veprim ndërmerret vetëm kur masat tjera më të buta nuk janë efikase.”<sup>118</sup>

Versioni në shqip i tekstit përcakton që përdorimi i prangave duhet raportuar duke dorëzuar formularin e përdorimit të forcës. Por, versioni në serbisht plotësisht e anashkalon nevojën për të dorëzuar arsyetimin zyrtar të atij veprimi. Thjesht parashikohet që përdorimi i prangave është përdorim force, forcë kjo që duhet ndërmarrë kur masat më të buta nuk janë apo nuk do të ishin efikase. Kështu, pragu për përdorimin e forcës në versionin në serbisht duket të jetë më i ulët sesa në versionin shqip. Kjo ka ndikim negativ të drejtpërdrejtë në të drejtat e individit. Gjithashtu, kërkesa përkatëse për arsyetim e parashikuar në versionin në shqip i mundëson individit që përdorimi i forcës ndaj tij/saj t’i nënshtrohet një mbikëqyrjeje efektive ligjore. Rrjedhimisht, versioni në serbisht i politikës – që ka status të barabartë autentik si ai në shqip – ndikon në të drejtat e individit për mjete efektive juridike. Dispozita e lartpërmendur është ndryshuar më 2007; kështu, kjo politikë nuk është më në zbatim. Megjithatë, ka brenga që politika ka qenë në përdorim për katër vjet dhe nuk është raportuar. Kjo përfaqëson një shembull të shquar të nivelit dhe rëndësisë së pasojave të një gabimi të thjeshtë përkthimi. Pas këshillave dhe ndihmës së OSBE-së, policia e Kosovës ka korrigjuar këto gabime në përkthim në Udhëzimin e ri Administrativ për Përdorimin e Forcës nga Oficerët e Policisë.<sup>119</sup>

<sup>113</sup> Kjo është shënuar në komunat: Pejë/Peć, Klinë/Klina, Istog/Istok, Gračanica/Gračanicë, Suharekë/Suva Reka, Skenderaj/Srbica dhe Viti/Vitina.

<sup>114</sup> Kjo është shënuar në komunën e Pejës/Peć (Zëvendës Kryetari për komunitetin serb, duke folur për përfshirjen e tij në seancat e Kuvendit Komunal).

<sup>115</sup> Kjo është shënuar në komunën e Pejës/Peć (Shefi i ZKK-së).

<sup>116</sup> Ky akt juridik ka qenë në fuqi deri në shtator të vitit 2009, kur është shfuqizuar nga Udhëzimi Administrativ nr. 06/2009 mbi Përdorimin e Forcës nga Oficerët e Policisë.

<sup>117</sup> Theksi i shtuar.

<sup>118</sup> Theksi i shtuar.

<sup>119</sup> Udhëzimi Administrativ nr. 06/2009 mbi Përdorimin e Forcës nga Oficerët e Policisë, nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, më 9 shtator 2009.

### *Shembull*

*Neni 5(d), Ligji mbi Arsimin në Komuna*<sup>120</sup>

Versioni në shqip i jep kompetencën për themelimin e komisionit për emërimin e drejtorëve të shkollave Kuvendit Komunal; derisa versioni në serbisht e fuqizon vetëm komunën, pa ndonjë përcaktim të veçantë.

Në një komunë, Kryetari ka marrë vendim për themelimin e komisionit të lartpërmendur – në pajtim me versionin në serbisht të nenit 5(d) të Ligjit mbi Arsimin në Komuna.<sup>121</sup> Pas këtij vendimi, kryetari është akuzuar nga opozita për shkelje të ligjit. Kjo e fundit i ka bazuar argumentet e saj në versionin shqip të dispozitës, e cila i jep kompetencën gjegjëse kuvendit komunal.

### *Shembull*

*Neni 44 (1), Ligji për vetëqeverisjen lokale*<sup>122</sup>

Versioni në shqip parashikon: “Takimi i jashtëzakonshëm i kuvendit të komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës, apo me kërkesë të kryetarit.”<sup>123</sup> Por, versioni në serbisht thotë: “Takimi i jashtëzakonshëm caktohet nga kryesuesi me kërkesë të së paku një të tretës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.”<sup>124</sup>

Në këtë rast, përkthimi i dobët çon në dallime në atë se kush jashtë Kuvendit Komunal mban kompetencën për të thirrur një seancë të jashtëzakonshme të kuvendit. Për më tepër, është vetëm versioni në shqip që kërkon kërkesë në formë të shkruar - versioni në serbisht bën fjalë vetëm për një kërkesë. Dallimet e tilla hapin derën për një spektër të gjerë të konflikteve të mundshme brenda procesit demokratik në nivelin lokal.

### *Shembull*

*Neni 53(1), Ligji për vetëqeverisjen lokale*

Versioni në shqip parashikon: “Komiteti për komunitete përfshin në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës, [...] Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete.”<sup>125</sup> Në anën tjetër, versioni në serbisht nuk parashikon rregullin e shumicës së thjeshtë, por përshkruan një strukturë tjetër, ku “Komiteti për Komunitete përbëhet nga anëtarë të Kuvendit Komunal dhe përfaqësuesit e komuniteteve”.<sup>126</sup>

<sup>120</sup> Ligji nr. 03/L-068 mbi arsimin në Komuna, 15 qershor 2008.

<sup>121</sup> Kjo është vërejtur në komunën e Suharekës/Suva Reka. Sipas nenit 58(a) të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Kryetari përfaqëson komunën.

<sup>122</sup> Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, 4 qershor 2008.

<sup>123</sup> Theksi është shtuar.

<sup>124</sup> Theksi është shtuar.

<sup>125</sup> Theksi është shtuar.

<sup>126</sup> Theksi i shtuar.



Në këtë rast, gabimi në përkthim ndikon në përbërjen e Komitetit për Komunitete. Edhe pse ishte paraparë ndryshimi i Ligjit për vetëqeverisje lokale, sipas zyrtarëve të MAPL-së, procesi i ndryshim-plotësimit është shtyrë për një fazë të mëvonshme.

#### *Shembull*

*P – 1.23, Mos-diskriminimi, I. Politika, Manuali i Politikave dhe Procedurave të Policisë së Kosovës (versioni 2007)*

Derisa versioni në shqip, i referohet diskriminimit në baza të gjuhës, orientimit politik, prejardhjes etnike apo sociale, përkatësisë me komunitet nacional, pronësisë, lindjes, paaftësisë, statusit familjar, shtatzënisë, apo ndonjë statusi tjetër, versioni në serbisht nuk ka referencë të tillë.

Si rezultat i përkthimit të dobët, versioni në serbisht i kësaj politike më herët nuk ka ndaluar diskriminimin në bazat e lartpërmendura. Pas këshillimit dhe ndihmës nga OSBE-ja, Policia e Kosovës ka korrigjuar gabimet në përkthim në versionin e ri të manualit.

#### *Shembull*

*Neni 86, Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës<sup>127</sup>*

Versioni në anglisht përcakton që në fund të mandatit të Kuvendit, gjitha punët që i janë besuar atij – përveç ligjeve të miratuara dhe të dorëzuara për shpallje – do të konsiderohen të papërfunduara. Por, versionet në shqip dhe serbisht e thonë të kundërtën: gjitha punët do të konsiderohen të përfunduara.

Pas shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës në vjeshtën e 2010-ës, gjitha projektligjet që nuk janë miratuar i janë dërguar prapë ZKM-së për ri-dorëzim në Kuvendin e sapozgjedhur. Kështu, versioni në anglisht – edhe pse nuk është gjuhë zyrtare – është respektuar nga zyrtarët. Dy versionet në gjuhë zyrtare janë anashkaluar. Është supozuar që draftet (e para) të Rregullores së Punës janë hartuar në anglisht, derisa gabimi është bërë gjatë përkthimit në gjuhën shqipe dhe serbe. Versionet në gjuhë zyrtare duken të mos pasqyrojnë vullnetin e ligjvënësit. Kjo rrugë veprimi është e pakënaqshme, nga këndvështrimi i sundimit të ligjit. Ndryshimet përkatëse duhen bërë urgjentisht.

### **3.2. Dega gjyqësore**

Probleme të ngjashme janë provuar edhe nga gjyqësori. Në intervistat që janë marrë nga OSBE-ja, disa gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë u pajtuan që përkthimet e ligjeve në serbisht, në lëmitë penale dhe civile, nuk kanë cilësi të mirë.<sup>128</sup> Njëri gjyqtar raportoi jo vetëm gabime gramatikore e sintaksore, por edhe përkthimet fjalë për fjalë të disa termeve juridike si gabime më të shpeshta.<sup>129</sup> Si rezultat, dispozitat shpesh janë të pakuptueshme, krijojnë huti apo thjesht s'kanë kuptim, sipas dy gjyqtarëve që merren me raste civile, në Prizren, përkatësisht në Prishtinë/Priština. Disa nga të intervistuarit<sup>130</sup> kanë theksuar që terminologjia

<sup>127</sup> Ndryshim-plotësimet e fundit në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës janë miratuar më 29 prill 2010.

<sup>128</sup> Një numër gjyqtarësh, prokurorësh dhe avokatësh në komunat: Prizren, Prishtinë/Priština dhe Mitrovicë/Mitrovica.

<sup>129</sup> Një gjyqtar në komunën e Prishtinës/Priština që merret me raste civile.

<sup>130</sup> Dy gjyqtarë, në komunë e Prishtinës/Priština, përkatësisht Mitrovicës/Mitrovica.

juridike që është tipike për të drejtën penale shfrytëzohet gjerësisht në tekstet e së drejtës civile, sidomos në Ligjin për procedurën kontestimore.<sup>131</sup> Versioni në serbisht i këtij ligji përmban dispozita në të cilat fjalë shqipe në dukje të rëndomta janë lënë krejtësisht pa përkthim.

Për të tejkaluar mungesën e qartësisë apo hutisë që krijohet nga përkthimi i dobët i teksteve ligjore, dy gjyqtarë kanë raportuar që kohë pas kohe janë detyruar të bëjnë interpretimet e veta (nganjëherë duke iu referuar ligjeve tjera, duke përfshirë ligjet e vjetra që nuk janë më në fuqi).<sup>132</sup> Pa marrë parasysh vlerën e mundit të bërë nga këto palë për tejkalimin e vështirësive të theksuara, praktika e tillë mund të rrezikojë interpretimin dhe zbatimin uniform të dispozitave përkatëse.

Konsultimet me gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët e sipërpërmendur e konfirmojnë që ligjet e përkthyerat dobët, në disa raste shkaktojnë pengesa shtesë në rrjedhën e procedurave gjyqësore. Një prokuror nga komuna e Prizrenit deklaroi që në disa raste atij i duhet t'i krahasojë të versionet e legjislacionit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, në mënyrë që të kuptojë domethënien e drejtë të dispozitës. Ai theksoi që praktika e tillë e vështirëson edhe më shumë mjedisin aktual të punës në komunë.

Për të ilustruar shtrirjen e pasojave të mundshme, që dalin nga përkthimi i dobët i legjislacionit, gjykatësi i referohet rastit ku kërkesa e paraqitur nga njëra prej palëve është refuzuar në bazë të versionit në gjuhën serbe, neni 258(4) të Ligjit për procedurën kontestimore. Si rrjedhim, përfaqësuesi ligjor i palës ka kundërshtuar vendimin, duke iu referuar versionit shqip të së njëjtës dispozite. Në rastin në fjalë, versioni në gjuhën shqipe dhe serbe për të njëjtin nen janë diametralisht të ndryshme, siç tregohet më poshtë.

### *Shembull*

#### *Neni 258(4), Ligji për procedurën kontestimore*

Në versionin e gjuhës serbe thuhet që: “gjykata në rastet, sipas paragrafit 2 të këtij neni, nuk e lejon ndryshim-plotësimin e kërkesës ...”.<sup>133</sup> Në anën tjetër, në versionin e gjuhës shqipe parashihet që: “gjykata e lejon ...”.<sup>134</sup>

Në bazë të versionit në gjuhën shqipe, propozimi i palës do të duhej të ishte i lejuar.

Pjesa dërmuese e palëve gjyqësore të intervistuarat kanë deklaruar që i janë shmangur vështirësive të mundshme lidhur me çështjet gjuhësore të paraqitura, falë përvojës së tyre të gjatë në sistemin gjyqësorë. Megjithatë, lidhur me këtë çështje, ata kanë shprehur shqetësimin për gjeneratën e re të praktikantëve ligjorë të cilët janë punësuar që atëherë pas procesit të verifikimit gjyqësor dhe prokurorial, i cili ka përfunduar në tetor të vitit 2010- e të cilëve u mungon niveli i njëjtë i përvojës.<sup>135</sup>

<sup>131</sup> Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, 20 shtator 2008.

<sup>132</sup> Një gjyqtar në Gjykatën komunale në Prishtinë/Priştina dhe një gjyqtar në Gjykatën Komunale në Prizren.

<sup>133</sup> Theksi është shtuar.

<sup>134</sup> Theksi është shtuar.

<sup>135</sup> Një numër i gjyqtarëve dhe prokurorëve në komunën e Prizrenit.

## 4. MEKANIZMAT PËR MBIKËQYRJE DHE AFTËSIM

Zbatimi i duhur i kornizës legjislative për përdorimin e gjuhëve kërkon mekanizma efektiv për mbikëqyrje dhe aftësim. Në njërin anë, mekanizmi mbikëqyrës duhet ta monitorojë gjendjen dhe kur nevojitet të ndërmarrë veprim adekuat. Në anën tjetër, ky mekanizëm mbikëqyrës duhet të mbështetet nga një organ aftësimi, që është përgjegjës për ofrimin e trajnimeve të rregullta për përkthyesit, për të ngritur kapacitetet e tyre.

OSBE-ja ka zhvilluar intervista me përfaqësuesit e organeve të ndryshme të përfshirë në mbikëqyrjen e përdorimit të barabartë të gjuhëve zyrtare në institucionet e Kosovës. Këtu përfshihen Komisioni i gjuhëve, Njësitë e të drejtave të njeriut dhe MAPL-ja. Për qëllime të këtij raporti, fokusi kryesor është vënë në përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare në projektligjet e miratuara.

### 4.1. Komisioni i gjuhëve

Komisioni i gjuhëve është organ qendror, që ka për detyrë të monitorojë institucionet lidhur me respektimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë. Mandati i tij mbikëqyrës shtrihet si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Sipas nevojës, Komisioni ndërmerr veprime për të mbrojtur statusin dhe përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare, duke përfshirë hartimin dhe nxjerrjen e legjislacionin në gjuhët zyrtare.<sup>136</sup>

Në një intervistë me anëtarët e Komisionit të gjuhëve, OSBE-ja ka mbledhur informatat në vijim për aktivitetet e Komisionit. Duke kryer vizita në institucionet përkatëse, Komisioni i gjuhëve mbledh informatat për ekzistimin e njësive të përkthimit në nivelin qendror dhe lokal, dhe për kapacitetet e personelit dhe pajisjet teknike të këtyre njësive.<sup>137</sup> Korniza ligjore në Kosovë nuk e parasheh qartë që çdo institucion publik të ketë njësi për përkthim. Megjithatë, kërkesa ligjore për të siguruar përkthimin me kohë dhe me cilësi të lartë të të gjitha dokumenteve zyrtare në gjuhët zyrtare, e bënë të domosdoshme ndarjen e burimeve njerëzore dhe financiare për shërbimet e përkthimit. Sipas raportimeve të intervistuesve, të gjitha ministritë dhe pjesa dërmuese e komunave kanë themeluar njësitë e përkthimit, me përjashtim të komunave të posa themeluara. Megjithatë, ata nënvizuan që kapaciteti operacional i Komisionit të gjuhëve është i dobët, meqë i mungon si buxheti ashtu edhe ndarja e duhur e buxhetit dhe hapësirës si dhe stimulimet financiare ose stimulimet tjera për anëtarët e tij. Anëtarët e Komisionit të gjuhëve gjithashtu theksuan që burimet buxhetore, teknike dhe njerëzore joadekuate paraqesin kërcënim ndaj përdorimit të barabartë si dhe statusit të barabartë të të gjitha gjuhëve zyrtare në legjislacionin e Kosovës. Ata shtuan që për shkak të këtyre arsyeve, Komisioni ka nevojë për mbështetje shtesë.

Përkundër problemeve me burime, anëtarët e Komisionit të gjuhëve kanë shprehur kënaqësinë për gjendjen e përgjithshme dhe funksionimin e kornizës ligjore dhe institucionale, në kuadër të së cilës funksionon komisioni. Gjithashtu, ata shtuan që ka ende hapësirë për përmirësim në nivelin lokal, veçanërisht sa i përket mekanizmit për ankesa, i cili

<sup>136</sup> Neni 32 i Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Puna dhe procedurat e Komisionit të gjuhëve definohe në mënyrë më të hollësishme me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë nr. 03/2007 për përbërjen dhe kompetencat e Komisionit të Gjuhëve.

<sup>137</sup> Është raportuar që informatat për çështje të personelit merren vetëm në nivelin qendror; në përgjithësi, nuk vlerësohen kualifikimet e përkthyesve por shikohet nëse komuna ka miratuar rregulloren përkatëse për përdorimin e gjuhëve.

është paraparë me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.<sup>138</sup> Në përgjithësi, ata janë të mendimit që ky ligj të zbatohet në tërësi nga pjesa dërmuese e komunave në Kosovë. Anëtarët e Komisionit, gjithashtu kanë theksuar që numri i vogël i ankesave mund të interpretohet si indikacion që publiku është i kënaqur me nivelin dhe cilësinë e përkthimit të dokumenteve publike, ose si shenjë që vetëdija tek popullsia në lidhje me të drejtat gjuhësore është mjaft e ulët.

Fakti që janë parashtruar vetëm katër ankesa para Komisionit ndërmjet mesit të vitit 2010 dhe gushtit 2011 gjithashtu mund të tregojë mungesën e vetëdijes publike mbi rolin e Komisionit të Gjuhëve, si dhe/ose mungesë besimi tek sistemi në përgjithësi. e shton brengosjen në këtë drejtim. OSBE-ja ka kërkuar që të adresojë këtë problem përmes organizimit të tryezave të rrumbullakëta në nivel të rajonit me synim të ngritjes së vetëdijesimit publik për rolin e institucionit dhe për ekzistimin e mekanizmave për ankim, si dhe sensibilizimin e zyrtarëve komunalë dhe publikun e gjerë për të drejtat gjuhësore të komuniteteve. Për më tepër, OSBE-ja ka ndihmuar Komisionin e gjuhëve në përpilimin e formularëve për ankim në gjuhën shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe gjuhët rome, në prill të vitit 2010. Komisioni i gjuhëve, në anën tjetër, ka raportuar për shpërndarjen e tyre nëpër të gjitha komunat në formë elektronike dhe gjithashtu ka premtuar që do t'i vendosë ato në faqen e vet të internetit.<sup>139</sup> Mirëpo, deri më sot ende nuk janë vendosur këta formularë. Prandaj, Komisioni i gjuhëve rekomandohet fuqimisht që të merr pozitë më aktive dhe më të dukshme duke shërbyer si shembull i mirë i respektimit të përdorimit të barabartë të gjuhëve zyrtare në Kosovë.

Në formën e vet aktuale, Komisioni i Gjuhëve nuk është në gjendje të ruajë, promovojë dhe mbrojë gjuhët zyrtare dhe statusin e tyre të barabartë në Kosovë, ashtu siç është paraparë nga ligjvënësi. Kjo kryesisht mund t'i atribuohet faktit që Komisioni i Gjuhëve kryen detyrat dhe përgjegjësitë e veta pa personel me orar të plotë dhe pa resurse adekuate. Kështu, në nëntor të vitit 2011, ZKM-ja ka themeluar një grup punues ndërministror për reformimin e Komisionit të Gjuhëve, në pajtim me rekomandimet që kanë dalë nga një punëtori e organizuar nga OSBE-ja në maj të vitit 2011, me fokus në përforcimin e kapaciteteve të Komisionit të Gjuhëve. Më 24 nëntor 2011, ky grup punues ka miratuar një dokument parimor politikash, duke bërë thirrje për vendosjen e Komisionerit të Gjuhëve bashkë me personelin e dedikuar me orar të plotë, me aftësinë e domosdoshme teknike dhe gjuhësore. Ai gjithashtu propozon krijimin e dy organeve mbështetëse: bordin e politikave gjuhësore, si dhe një rrjet politikash për gjuhët. Themelimi i bordit të politikave gjuhësore ka të bëjë, mes tjerash, me hartimin e politikave për gjuhët në bashkëpunim me zyrën e Komisionerit të Gjuhës. Krijimi i propozuar i rrjetit të politikave për gjuhët, të përbërë nga persona kontaktues nga institucionet publike do të ndihmonte në të siguruarit të zbatimit të plotë të politikave të gjuhës. Grupi punues duhet të ri-hartojë udhëzimin administrativ i cili rregullon përbërjen dhe kompetencat e Komisionit të Gjuhëve, si dhe të hartojë termat e referencës dhe përshkrimet e punës, të cilat do t'i sigurojnë komisionerit të gjuhëve drejtimin dhe orientimet e domosdoshme.

OSBE-ja inkurajon përpjekjet, edhe me politika edhe ato legjislative, me qëllim të reformimit dhe përforcimit të Komisionit të Gjuhëve. Gjendja e tij aktuale joefektive mund të rregullohet duke definuar kompetencat e tij si organ mbikëqyrës dhe si organ kompetent për promovimin e një sistemi të kontrollit të cilësisë, i cili do të siguronte edhe shërbime të sakta përkthimi.

<sup>138</sup> Neni 32(3) i Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

<sup>139</sup> Mund të gjendet në: <http://www.ks-gov.net/kgjz/home.aspx> (qasur më 8 gusht 2011).

## 4.2. Njësitë për të drejtat e njeriut

Që nga viti 2008, Ligji për vetëqeverisjen lokale ka paraparë “promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal” si kompetencë e plotë e pushtetit lokal.<sup>140</sup> Si rrjedhim, Njësitë për të drejtat e njeriut janë themeluar në pjesën dërmuese të komunave si mekanizma përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel komunal.<sup>141</sup>

Mandati relativisht i gjerë i këtyre organeve mbulon shumë fusha të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat gjuhësore të gjitha komuniteteve<sup>142</sup>. Korniza legjislative parasheh që Njësitë për të drejtat e njeriut në kuadër të ministrive duhet të marrin pjesë edhe në hartimin e legjislacionit.<sup>143</sup> Prandaj, këto njësi duhet të kenë rol plotësues krahas Komisionit të gjuhëve në sigurimin e cilësisë së lartë të gjuhës dhe përkthimit në gjuhën përkatëse të (projekt)ligjeve.

## 4.3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Komunat e Kosovës gëzojnë shkallë të lartë të autonomisë.<sup>144</sup> Megjithatë, ato janë të obliguara të veprojnë në pajtim me ligjet ekzistuese.<sup>145</sup> Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL-ja) është institucioni qendror për të shqyrtuar dhe siguruar ligjshmërinë e aktiviteteve komunale. Komunat janë të obliguara t’i dorëzojnë “të gjitha aktet e miratuara nga kuvendet komunale”, “vendimet lidhur me aktivitetet e përbashkëta dhe bashkëpunimit në partneritet” si dhe “aktet e miratuara në kuadër të kornizës së zbatimit të kompetencave të deleguara” MAPL-së për shqyrtimin e detyrueshëm të ligjshmërisë sipas nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Si rrjedhim, MAPL-ja lëshon mendimin e saj për ligjshmërinë e këtij akti.<sup>146</sup>

Nocioni i ligjshmërisë nënkupton zbatim të saktë të ligjit. Kjo përbëhet nga të gjitha kërkesat materiale dhe procedurale të përcaktuara me kornizën përkatëse ligjore. Neni 3 i Ligjit për vetëqeverisje lokale thotë që “...shqyrtimi i ligjshmërisë ... i kryer nga autoriteti mbikëqyrës [në parim MAPL-ja]<sup>147</sup> ... [është]<sup>148</sup> ... të sigurojë që aktet komunale janë nxjerrë në pajtim me dispozitat ligjore të zbatueshme”. Pavarësisht nga pavarësia thelbësore institucionale, që e

<sup>140</sup> Shih nenin 17.1(i), Ligji për vetëqeverisjen lokale.

<sup>141</sup> Neni 1 i Udhëzimit administrativ nr. 2011/01 për themelimin e njësive për të drejta e njeriut në komuna, i MAPL-së, më 29 mars 2011. Ky e zëvendëson Udhëzimin administrativ nr. 2008/02 për ndryshimplotësimin e Udhëzimit administrativ nr. 2007/08 mbi themelimin e Njësive për të drejtat e njeriut në komuna.

<sup>142</sup> Në lidhje me të drejtat gjuhësore të përligjura me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, shih nenet 26 dhe 27 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; nenet 2, 10, 19 dhe 26 të Deklaratës Universale për të Drejtat e njeriut; Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale apo të Pakicave; si dhe Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

<sup>143</sup> Sipas nenit 10(5) të Udhëzimit administrativ 2007/4 për Njësitë e të drejtave të njeriut në Qeverinë e Kosovës, “Sekretari i Përhershëm i Ministrisë siguron pjesëmarrjen e NJDNJ-ve në grupe punuese të ndryshme ministrore dhe ndërministrorë, duke përfshirë gjithashtu çështjet e hartimit të legjislacionit dhe bërjes së politikave.” Shih gjithashtu nenin 7(1)(iv) të Udhëzimit administrativ të SP/ZKM nr. 2005/8.

<sup>144</sup> Siç parashihet me Ligjin për vetëqeverisjen lokale. Kjo është ritheksuar në një gjykim të kohëve të fundit të gjykatës kushtetuese, në rastin e *Kryetarit të Rahovecit/Orahovac Z. Qazim Qeska* nr. KO 80/10, Aktgjykim i 7 tetorit 2010, paragrafi 29.

<sup>145</sup> Shih nenin 12(2) të Kushtetutës së Kosovës.

<sup>146</sup> Shih nenet 3 dhe 82 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

<sup>147</sup> Theksi është shtuar.

<sup>148</sup> Theksi është shtuar.

gëzojnë komunat sipas kornizës ligjore ekzistuese, kompetenca për shqyrtimin e ligjshmërisë që e ka MAPL-ja, duhet të ushtrohet në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse. Shqyrtimi i ligjshmërisë kërkon që MAPL-ja të sigurojë që aktet komunale të nxirren në pajtim me kornizën e gjerë ligjore, duke përfshirë Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Prandaj, kur vlerësohet ligjshmëria e aktit komunal, MAPL-ja duhet gjithashtu të kontrollojë materialin e vet dhe aspektet procedurale, duke përfshirë këtu disponueshmërinë e akteve ligjore në të gjitha gjuhët zyrtare dhe cilësinë përkatëse të tyre.

Në një intervistë të bërë me një zyrtar të MAPL-së, i cili është drejtpërsëdrejti përgjegjës për procesin e shqyrtimit, ai nënvizoi obligimin ligjor të komunave për lëshimin e akteve të tyre në të gjitha gjuhët zyrtare. Sidoqoftë, kjo intervistë zbuloi që disponueshmëria e aktit komunal në të gjitha gjuhët zyrtare ose cilësia e versioneve të ndryshme, në praktikë nuk parashihet në kuadër të fushës së shqyrtimit të MAPL-së. Në përgjithësi, MAPL-ja kontrollon vetëm përmbajtjen e aktit ligjor komunal. Sipas përfaqësuesit të MAPL-së, të gjitha çështjet e përdorimit të gjuhëve bien nën përgjegjësinë e Njësive përkatëse komunale për të drejtat e njeriut. Megjithatë, duket se nuk ka bashkëpunim të mjaftueshëm dhe shkëmbim adekuat të informatave ndërmjet Njësive komunale për të drejtat e njeriut dhe MAPL-së.

Në anën tjetër – si një rast i veçantë – OSBE-ja është informuar për instancën kur MAPL-ja ia ka kthyer aktin komunës, për shkak që nuk ka qenë i përkthyer në të gjitha gjuhët zyrtare. Si rrjedhim, komuna i ka dorëzuar përkthimet e kërkuara MAPL-së.<sup>149</sup> Ky rast tregon për shqyrtimin gjithëpërfshirës nga ana e MAPL-së dhe kështu tregohet një demonstrim shembullor i bashkëpunimit të suksesshëm ndërmjet nivelit lokal dhe qendror. Si rezultat, akti komunal është në dispozicion në të gjitha versionet e gjuhëve zyrtare dhe në këtë mënyrë edhe në pajtim me ligjin. Ky rast i praktikës më të mirë duhet t'i shërbejë MAPL-së si udhëzues për aktivitetet mbikëqyrëse të ministrisë në të ardhmen. Megjithatë, rezultatet e OSBE-së për aktivitetet e monitorimit të rregullt si dhe intervistat e bëra për këtë raport tregojnë që nuk ka mekanizëm të mbikëqyrjes sistematike dhe nuk kuptohet qartë roli mbikëqyrës i MAPL-së, sa i përket disponueshmërisë së akteve komunale në të gjitha gjuhët zyrtare të komunave.<sup>150</sup> Prandaj, kjo duhet të rregullohet në mënyrë të veçantë me ligj, në mënyrë që të shmanget dykuptimësia në fushën e shqyrtimit nga ana e MAPL-së në këtë drejtim.

## 5. PËRFUNDIM

Korniza ligjore ofron mbrojtje qenësore për të drejtat gjuhësore gjithëpërfshirëse të komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Të gjitha institucionet e Kosovës kërkojnë që ta respektojnë statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare në punën e tyre dhe të sigurojnë që e drejta e barabartë për qasje në informata është në dispozicion për të gjithë. Kjo përfshin hartimin e legjislacionit në të gjitha gjuhët zyrtare që në fazat e hershme. Në këtë mënyrë, institucionet do të lehtësonin dhe inkurajonin përfshirjen e të gjitha komuniteteve në çështjet publike. Megjithatë, zbatimi i kornizës ligjore mbetet i mangët.

Zakonisht, gjatë fazës në ministri, faza fillestare e tërë procesit hartues realizohet në gjuhën shqipe. Vetëm para dorëzimit në ZKM, projektligji përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze.

<sup>149</sup> Rregullorja për tarifat mjedisore dhe Rregullorja për tatimet në pronën e paluajtshme të komunës së Shtimes/Štimlje, i janë dërguar fillimisht MAPL-së vetëm në gjuhën shqipe.

<sup>150</sup> Neni 2(3) i Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Ju lutem shihni shënimet 6 dhe 7, sipër.

Me kërkesë të veçantë, ofrohet përkthim edhe gjatë takimeve të grupit punues. Nuk ekzistojnë dispozita të qarta të cilat në veçanti rregullojnë përkthimin e projektligjeve si dhe shpeshherë mungon vetëdija për rëndësinë e përfshirjes së komuniteteve jo-shqiptare. Në këtë drejtim, OSBE-ja mirëpret praktikën tipike që aplikohet nga MKK-ja për procedimin e hartimit të legjislacionit në të dy gjuhët zyrtare që nga faza fillestare e hartimit. Veç kësaj, herë pas here përkthimi i projektligjeve është i dobët dhe shkakton huti për përmbajtjen e projekt ligjit.

Në nivelin e Kuvendit të Kosovës, procedurat e përkthimit duken të jenë të kënaqshme. Gjatë takimeve të komisioneve, ndryshim-plotësimet e veçanta përfshihen drejtpërsëdrejti si në versionin e gjuhës shqipe ashtu edhe në atë serbe të projektligjit, pas marrjes së vendimit. Në secilin takim të komisionit ofrohet përkthim simultan në gjuhën serbe dhe shqipe si dhe në gjuhën turke, nëse ashtu kërkohet. Megjithatë, nuk aplikohet ndonjë praktikë sistematike e lektorimit të versioneve që nuk janë në gjuhën shqipe.

Më shumë se një e treta e komunave të Kosovës nuk i përkthejnë projektligjet e miratuara në të gjitha gjuhët zyrtare. Në vend të kësaj, ata i mbajnë aktet ligjore vetëm në një gjuhë zyrtare. Megjithëse, ekzistojnë komuna që kanë praktika për lëvdatë dhe të gjitha aktet ligjore i kanë në të gjitha gjuhët zyrtare, që nga faza fillestare. Kjo dëshmohet të jetë e rëndësishme në kontekst të pjesëmarrjes së shumë komuniteteve në punët komunale. Në këtë drejtim, të gjitha komunat priten që të zbatojnë këtë praktikë të paraqitur në mënyrë uniforme pavarësisht nga përbërja e tyre demografike.

Dështimi për sigurimin e legjislacionit në të gjitha gjuhët zyrtare ose sigurimin e cilësisë së përkthimit ndikon negativisht në pjesëmarrjen e përgjithshme të komuniteteve në çështjet publike. Për më tepër, kjo mund të ndikojë drejtpërsëdrejti në individin që i nënshtrohet aktit të caktuar ligjor. Prandaj, praktika e tillë krijon pasiguri ligjore dhe bënë shkeljen e parimeve të barazisë para ligjit. Kjo bie në kundërshtim me zbatimin e drejtë dhe koherent të të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve. Si rezultat, kjo mund të minojë respektin dhe besimin e publikut ndaj institucioneve publike dhe sundimit të ligjit.

Për të siguruar përdorim të barabartë të gjuhëve zyrtare në legjislacion dhe cilësi të mirë të tyre, është i rëndësishëm thelbësorë një mekanizëm i fortë, funksional dhe mbikëqyrës. Komisioni i gjuhëve, Njësitë për të drejtat e njeriut dhe MAPL-ja përbëjnë organet qendrore në këtë drejtim. Kapaciteti operacional i Komisionit të gjuhëve është i dobët, meqë i mungon buxheti i veçantë dhe hapësira e punës, derisa anëtarët e tij nuk paguhen. Pa mbështetje të mëtutjeshme financiare, Komisioni nuk mund ta përmbushë mandatin e tij. Ndonëse mekanizmi për ankesa i paraparë me Ligjin për përdorimin e gjuhëve është mjet i dobishëm, atij akoma i mungon qasja dhe dukshmëria e duhur para publikut, gjë që e dëmton ndikimin e këtij mekanizmi në tërësi. Njësitë për të drejtat e njeriut në çdo ministri kanë dëshmuar të jenë një mekanizëm efikas për vlerësimin e cilësisë dhe pajtueshmërisë reciproke të versioneve të gjuhës së legjislacionit në raste të veçanta. Prandaj, Njësitë për të drejtat e njeriut nuk u lejohet rol aktiv në hartimin ligjor në pjesën dërmuese të ministrive në Kosovë. MAPL-ja, përmes kompetencës së saj për shqyrtim administrativ, monitoron ligjshmërinë e aktiviteteve komunale, duke përfshirë pajtueshmërinë me Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Megjithëse, MAPL-ja duhet të ndër marrë një rol më aktiv në shqyrtimin e disponueshmërisë së akteve ligjore në të gjitha gjuhët zyrtare dhe cilësinë e tyre përkatëse.

Në përmbyllje, zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve lidhur me përkthimin e projekt ligjeve nuk është i kënaqshëm. Përkthimi i dobët i legjislacionit, dominon si në nivelin

qendror ashtu edhe në atë lokal. Sipas vlerësimeve, shumë prej pengesave të identifikuara për përkthimin e projekteve me kohë dhe saktësi janë të zakonshme pothuajse në të gjitha institucionet e Kosovës, duke përfshirë si në vijim: mungesën e kualifikimit profesional të përkthyesve dhe financimit të pamjaftueshëm të njësisë për përkthim; mungesën e lektorimit sistematik; mungesën e vetëdijesimit dhe informimit të publikut dhe mbikëqyrjen e pamjaftueshme. Rezultatet e intervistave sugjerojnë gjithashtu, që mungesa e vullnetit të një pjese të institucioneve përgjegjëse për hartimin dhe nxjerrjen e legjislacionit në të gjitha gjuhët zyrtare luan rol të madh në një numër të rasteve.

## **6. REKOMANDIMET**

Sipas asaj që u tha më lartë, OSBE-ja rekomandon veprimet vijuese:

### **Niveli qendror**

Për Kuvendin e Kosovës:

- Të sigurojë burime financiare për Komisionin e gjuhëve, IKAP-in dhe njësitë për përkthim në nivelin qendror, në mënyrë që të ua mundësojë përmbushjen e mandatit të tyre (p.sh. burimet për përkthyes të kualifikuar, trajnim për ngritje të kapaciteteve, hapësirë të punës dhe pajisje teknike);
- Të sigurojë udhëzime ose rregullore për përkthimin e projektligjeve dhe ndryshimplotësimeve e tyre gjatë seancave të komisionit, në mënyrë që të lejohet pjesëmarrja e plotë e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë;
- Të vazhdojë me sigurimin e procesverbaleve gjithëpërfshirëse dhe profesionale të të gjitha seancave plenare dhe takimeve të komisionit për të shmangur problemet e mundshme që dalin nga mospërputhshmëria e versioneve të gjuhëve zyrtare të ligjeve.

Për Zyrën e Kryeministrit:

- Të ndajë burime financiare adekuate për Komisionin e gjuhëve, IKAP dhe njësitë e përkthimit në nivel qendror të iu mundësojnë që ta përmbushin mandatin e tyre (p.sh. burime për përkthyes të kualifikuar, trajnime për ngritje të kapaciteteve, hapësirë të mjaftueshme të punës dhe pajisje teknike);
- Të fuqizohet Komisioni i Gjuhëve që të monitorojë efektivisht dhe të mundësojë zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve përmes themelimit të Komisionerit të Gjuhëve, të mbështetur nga personeli i dedikuar me orar të plotë, me aftësitë e domosdoshme teknike dhe gjuhësore, si dhe me resurset adekuate.
- Të vendosë lektorimin në baza ad-hoc ose në baza të 'atypëratyshme' si pjesë e procesit për shqyrtimin e legjislacionit. Kjo do të sigurojë që të gjitha versionet e gjuhëve të projektligjeve të dorëzuara ZSHLM-së për shqyrtim, të jenë në përputhje me përmbajtje dhe terminologji dhe secili version të jetë i cilësisë së duhur;

Për ministritë:

- Të sigurojnë që projektligjet të jenë në dispozicion në gjuhët zyrtare për grupet punuese ministrore dhe ndërministrrore (veçanërisht në grupet punuese ku merr pjesë shoqëria civile dhe publiku i gjerë), dhe çdo version të jetë në pajtim me të gjitha versionet tjera dhe i cilësisë së duhur;



- Të ofrojnë udhëzime ose të rregullojnë në mënyrë precize përkthimin dhe ndryshimplotësimin e projektligjeve në faza të ndryshme të grupeve punuese për projektligje para dorëzimit të tyre në Kuvendin e Kosovës;
- Të vendosin praktikën e lektorimit të legjislacionit të hartuar/përkthyer nga stafi i përcaktuar për përkthim;
- Në rastet kur përkthimi kontrahohet së jashtmi, të sigurohet që kriteret për përzgjedhjen e agjencive të kontraktuara për përkthim, të ngarkuara me përkthimin e projektligjeve, të përfshihen edhe disa kërkesa të caktuara profesionale (p.sh. specializimi ose përvoja e mëparshme në përkthimin e teksteve ligjore) dhe të krijojnë një bazë të përbashkët të të dhënave mbi agjencitë profesionale të përkthimit;
- Sekretari i përhershëm i ministrisë përkatëse duhet të ftojë Komisionin e gjuhëve për të marrë pjesë në mënyrë aktive në hartimin e legjislacionit të përzgjedhur.

#### Për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal:

- Të merr parasysh sigurimin e disponueshmërisë së të gjitha akteve komunale në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës përkatëse si pjesë zyrtare e rolit të saj mbikëqyrës. Lidhur me këtë, duhet të kërkohet që të gjitha aktet ligjore komunale nga komunat që i dorëzohen MAPL-së për shqyrtim të ligjshmërisë, duhet të jenë në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës;
- T'i pajisë komunat me këshilla dhe udhëzime përkatëse lidhur me obligimin e tyre për ruajtjen e statusit të barabartë dhe përdorimit të barabartë të të gjitha gjuhëve zyrtare në punën e tyre, veçanërisht për hartimin dhe publikimin e gjithë legjislacionit të nivelit lokal në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës pavarësisht nga përbërja demografike e komunës;
- Të vendosë bashkëpunim më të ngushtë me Njësitë komunale për të drejtat e njeriut dhe bashkërendim të rregullt me Komisionin e gjuhëve dhe të marrë në konsideratë vlerësimin e tyre të pajtueshmërisë reciproke të versioneve të gjuhëve të ndryshme të legjislacionit kur bëhet shqyrtimi i ligjshmërisë;
- Të këshillojë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave që të propozojë burime financiare adekuate për themelimin e njërive të përkthimit në komuna (p.sh. burimet për punësimin e një numri të mjaftueshëm të përkthyesve të kualifikuar, për t'iu ofruar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të përkthyesve, hapësirë dhe pajisje adekuate).
- Të korrigjojë mospërputhjet mes versioneve në dy gjuhët zyrtare të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

#### Për Ministrinë e Administratës Publike:

- Të themelojë një program profesional të certifikimit për përkthyes dhe interpretë të shërbimit publik, si dhe të sigurojë – bashkë me IKAP-in - ofrimin e trajnimeve të obligueshme për ndërtim kapacitetesh të të gjithë përkthyesve dhe interpretëve në sektorin publik, për të siguruar zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional.
- Të kërkojë caktimin e kualifikimit minimal (p.sh. shkollimi ose përvoja) në procesin e rekrutimit për përkthyesit që të punësohen në sektorin publik;

#### Për Komisionin e Gjuhëve:

- Të monitorojë nëse institucionet e Kosovës i përmbahen obligimeve të veta për mbajtjen dhe nxjerrjen e të gjitha dokumenteve zyrtare, duke përfshirë projektligjet në nivelin qendror dhe lokal në të gjitha gjuhët zyrtare dhe nëse çdo version ka

cilësinë e duhur gjuhësore. Në këtë drejtim, Komisioni duhet të angazhohet në bashkëpunim me Njësitë komunale për të drejtat e njeriut;

- Të mbështesë MAPL-në në aktivitete e saja për shqyrtimin e ligjshmërisë, duke bërë vlerësimin lidhur me përputhshmërinë gjuhësore të akteve ligjore komunale;
- Të marrë pjesë në mënyrë aktive në grupet punuese të përzgjedhura për projektligje, duke e shqyrtuar cilësinë dhe pajtueshmërinë reciproke të versioneve të ndryshme të gjuhëve;
- Të rrisë vetëdijen për mekanizmin ekzistues për ankesa si dhe për të drejtat e individëve dhe komuniteteve, sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare. Në këtë drejtim, inkurajohen fuqishëm aktivitetet për ngritjen e vetëdijes, ku janë të përfshira mediat lokale dhe shoqëria civile;
- Të monitorojë nëse janë themeluar njësitë për përkthim në institucionet e Kosovës dhe të angazhohet në vlerësimin e rregullt të punës së njërive për përkthim në nivelin qendror dhe lokal, në mënyrë që të identifikojë nevojat e tyre për ngritjen e kapaciteteve;
- Të ndihmojë në përgatitjen dhe zbatimin e trajnimeve profesionale të përshtatshme për përkthyesit në bashkëpunim me Njësitë komunale për të drejtat e njeriut, MAPL-në, MAP-in si dhe IKAP-in.

Për IKAP-in:

- Të sigurojë trajnime për ngritje gjithëpërfshirëse dhe të rregullt të kapaciteteve – duke përfshirë trajnimin e certifikuar profesional për aftësi të avancuara përkthimi dhe interpretimi, si dhe trajnime të specializuara për terminologjinë juridike - të përkthyesve në nivelin qendror dhe lokal, në bashkëpunim me Komisionin e gjuhëve, MAP-in, MAPL-në dhe Njësitë për të drejtat e njeriut, për të siguruar zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional.

### **Niveli lokal**

Për komunat e Kosovës:

- Të sigurojnë që njësia për përkthim të jetë themeluar në çdo komunë dhe që të jenë pajisur me numër të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar dhe kushte adekuate të punës (p.sh. hapësira dhe pajisjet përfshirë këtu fjalorët, kompjuterët dhe softueri), në mënyrë që të garantohet e drejta e mirëfilltë për lirinë e informimit;
- Të caktojnë procedurë të qartë për përkthim të kontraktuar (p.sh. pajtueshmëria me procedurat ekzistuese të tenderimit, saktësia në ofrimin e shërbimeve dhe cilësia e përkthimit);
- Të mbajnë dhe lëshojnë të gjitha dokumentet zyrtare të komunës, duke përfshirë projektligjet në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës në mënyrë që të bëhet lehtësimi dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve në procesin e hartimit;
- Të paraqesin praktikën e lektorimit të legjislacionit të hartuar/përkthyer nga lektorët profesional.

Për Njësitë e të drejtave të njeriut në komuna:

- Mbështetja e MAPL-së përmes shpërndarjes së informatave për disponueshmërinë e akteve komunale në të gjitha gjuhët zyrtare dhe cilësinë e tyre.

## **Bashkësia ndërkombëtare**

- Të përkrahë financimin adekuat të njësive për përkthim në nivelin qendror dhe lokal si dhe Komisionin e gjuhëve;
- Të vazhdojë monitorimin e përputhshmërisë së gjuhës së legjislacionit në të gjitha gjuhët zyrtare.